



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË SHTATË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 28.06.2024 (e martë) në shtëpinë e kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Sokol Shaqiri, z.Ramadan Deliu, z.Basri Sylejmani, znj.Valentina Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Ali Bajrami, z.Ekrem Ymeri, z.Arbnora Hajredini, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emimi, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, z.Durim Sylejmani, , znj.Majlinda Shabani, z.Taulant Haxhiu, z.Musli Neziri, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, z.Veton Ramadani, znj.Anisë Zejnullahu, z.Sokol Hyseni, z.Illir Zuka, z.Reshat Azizi ndërsa mungoi znj.Marigona Avdiu, znj.Lindita Demelezi, znj.Zyrafete Rama.Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike dhe të tjerë.

Pasi u konstatua se prezent janë 24 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e gjashtë të rregullt të Kuvendit! Gjatë kësaj peridhde kemi pas konfirmimin e ligjshmërisë të disa akteve që janë kthy në pajtim me ligjet në fuqi. Kemi pas një interpretim të ministrisë lidhur me votim të seancës së kaluar kur kemi pas një moment të shfuqizimit të një vendimi që kanë votu 10 për, 1 kunder, abstenim nuk ka pas dhe 6 të tjerë janë deklaruar që nuk votojnë, dhe në vazhdimësi kemi bë një interpretim, dhe para dy dite ministria na e ka kthy konfirmimin që thotë, kuorumi ka qenë i mjaftueshëm, ligji nuk e njeh mos votimin nëse është prezent ai të llogaritet si abstenim dhe prej 17, 10 thotë kanë votu për edhe e shfuqizon vendimin. D.m.th ministria na e ka kthy votimin e plotfuqishëm para 2 diteve na e ka kthy me insismitn e nënkryetarit. D.m.th kemi diskutu me Zyrën Ligjore të ministrisë dhe ata kanë kërku dhe me shkrim e kanë kthy këtë. Materialin e keni marrë me kohë, para se me hy në rend të ditës hapi diskutimin për pyetje dhe përgjigje, por mudënsisht të ju përmbahemi kohës.

z.Illir Zuka: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë kam 2 pyetje. Pyetja parë ka të bëjë me ndriçimin publik në Pozheran. Jemi mundu shumë edhe me kryetarin, por edhe me menaxherin e kontratës, është një kompani e Prishtinës që e ka marrë ndriçimin, kemi jashtëzakonisht shumë problem në Poheran për ndriçim, në Pozhera ka shumë drita të djegura nëpër lagje, në rrugën kryesore dhe mbi 1 muaj ka që e thirim dhe nuk vjen. Plus që mu marrë pak më seriozishtë më atë punë, se ka ankesa shumë prej qytetarëve. Dhe pyetja e dytë ka të bëjë për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Lus drejtoreshën te aborri në Pozheran jashtëzakonisht ka barnishta të mëdha, ajo pjesa që është ngjitë me ambullatnën, kërkoj që me gjetë një zgjidhje me hekë atë, se kanë problem edhe bizenset afër që kanë me të, por edhe të ambullantes. E di që është një shqetësim aty dhe kanë kërku që me intervenu.

z.Ali Bajrami: Përshendetje për të gjithë pranishmit! Kam pyetje për drejtroeshën e financave lidhur me fondin e Bashkimit European, Krosborderit, Komunës së Gostivarit dhe Komunës së Vitisë. Më intereson ta di sa është vlera montere e këtij bashkëpunimi? Edhe një nënpyetje në kuadet të saj: kush është menaxher i këtij projekti. Dhe pyetjen e dytë rreth debateve me qytetarët. A i keni parapa që mjaftojn 4 apo ndërkohë do të ketë ndonjë plotësim apo ndryshim të këtij propozimi që e keni dhanë, që e pash përmes rrjeteve elektronike.

z.Taulant Haxhiu: Përshendetje për të gjithë të pranishmit. Unë nënkryetar e kam një shqetësim jashtëzakonisht të madh. Më beso që në Viti nuk po muj me dalë prej ankesave të qytetarëve të cilët sot janë në panik. Sheshi është blloku i tëri. Vitisë i vynë parqe, i vynë gjelbrim, jo ta bllokun sheshin ashtu në këtë mënyrë qysh e keni bë. Edhe fjalët që i kam thanë para 2 muajve po dalin. Edhe 2 javë ditë këtu vërshojnë mërgimtarët, më sa paku i kemi edhe 2-3 mijë vetura të reja që na vijnë prej botës së jashtme, që vijnë për pushime në Kosovë. 15-16-17 korriku është data që veç fillojnë me ardh krejt. Më beso, qysh e keni planifikuar këtë projekt e keni nis, e keni bë. Ka kanë me lëviz qytetarët e Vitisë, ka kanë me shku ata me vetura, ka kanë me hy në Viti? Më zorë është bërë me hy në Viti se në Nju Jork. Unë kam qenë dhe në Nju Jork, e di si është, po më duket qëky projekt që është nis, po nuk jeni tu e ditë as ju çka bohet me do qytetarë, nuk e dinë saktësisht, nuk kanë informatë ka do të lëvizin, ka do të shkojnë edhe ata që kanë shërbime me mallra, ka i planifikojnë ato, ka mi qu, ka mi dërgu. Domethanë qyteti është i bllokum i tëri, kubëzat që i keni ndërru besoni qeto kubëzat që janë sot që i keni ndërru, ato të vjetrat 10 herë janë kanë ato të vjetrat që i keni ndërru pa pas nevojë. Edhe qetu qe jeni krejt ishalla jena rahat mas dy vjete këto kubëza nuk janë të qëndrueshme si ato. Unë nuk pe di çfarë ndryshimi u bë me keto kubëza qe janë kanë të vjetra i keni vnu të reja. Unë nuk pe shoh ndonjë ndryshim atje te grandit i performancës te kalldërmi. Kallxonem ju mue, na aty qysh mujna me lëviz kerret, mjetet e rënda. Euroabi ndëgjova që ka bë një kërkesë për dy ndërtesa mi fillu treja aty. Në qoftë se i japin lejen, kah lëviz ai, ai duhet me shku me bagera, me shlipera, ato që kanë ngarkesë të madhe si mund ta përballon atë ngarkesë të madhe kur të bëhen investime të kalon dikush aty ska alternativë, edhe qysh mundet me qëndru ai kalldërm, ai investim që u bë aty prishet kur të hynë mjetet e rënda aty e mledhet kalldërmi. Unë nuk kom pa kalldërm ma të dobët, projekt më të dobët beso që nuk kom pa. Rrugën që e keni qit natana dykahëshe ka ura, ajo duhet me ardh në kuvend, me pas miratim të kuvendit, e keni qit pa e vet kërkan si partizana. Qytetarët e Vitisë janë në panik të jazhtëzakonshëm, nuk kanë informim se çka do të bëhet me ta, edhe bizneset e Vitisë pasi vij prej biznesit, beso që kanë me pas një kolaps këtë sezon. I them bizneseve të Vitisë që, qytetarët e Vitisë nuk kanë me ardh dhe me hargju pare në Viti, kanë me dalë në Gilan dhe Ferizaj, se nuk mujnë me hy në Viti nga kolapsi. Në qoftë se bizneset shënojnë regres në sezon, faji është i qeverisjes komunale, ata kanë me ik në Gilan dhe Ferizaj. Vjen ai prej Zvicre, Gjermanisë donë me hy në qytet, nuk hinë e shef kolon e ka alternativën Gilan dhe Ferizaj. Ju lutem, me qytetarët të jeni pak më të sinqert. 17 korriku z.Aliu edhe 18 ditë vjen. A mundemi me i përfundu ne punimet që janë duke u bë në Viti? Që është bërë kaos Vitia. A e ke shiku rrugën me kallderm, dhe e di që më tregon shumë sinqert: a mundet me qendru ai kallderm në qoftë se lëvizin me mjete të rënda aty? Aty kanë me u bë investime. Si mund një mjet i rënd me kalu aty dhe pa u dëmtu kalldermi me atë kualitet që unë e pash, kam shku vetë me doren time e kam kapë. Dëgjo, është shqetësim i jashtëzakonshëm, po bllokohet qyteti, po bllokohen qytetarët pa asnjë analizë të detajuar. Vitia është në panik, qytetarët e saj janë në panik. Ju ka thanë Taulant Haxhiu në nëntor, ka me ju zanë sezona edhe 14 ditë, 14 ditë janë si 14 orë.

z.Sejdi Emini: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Po kyqem dhe unë pak te sheshi, kemi qenë ndër ata që kemi kërku që Vitia është e domosdoshme me qenë një shesh, u diskutu që gjatë punës po paraqiten probleme. Unë mendoj që nuk ka qenë zgjidhje as heren e parë që është shtru, por nuk është zgjidhje as tash që po bëhet ky shesh dhe kjo punë. Pse? Zgjidhje është dashtë të behte prej pasqyres deri këtu te lumi një parking nëntokësor, një nënkallim nëntokësor që të jetë investim i përhershëm, afatgjatë dhe zgjidhje e përhershme për qytetarin e Komunës së Vitisë, ku nuk do të kishte probleme as për qytetarin, as për bizensin, as për komunikacionin. D.m.th e njëjta punë pas disa viteve është e domosdoshme prapë me u hargju pare prapë që me u bë një zgjidhje e përshtatshme dhe e përhershme për qytetarin e komunës sonë. Jam më se i sigurt që në të ardhmen është e domosdoshme me u bë një nënkallim nëntokësor prej pasqyres deri lumi, që do të ishte tani hapësira mbi nënkallimin që do të shfrytzohej shumë mirë automjetet nëntokë e qarkullimi këmbësor e bizneset mbi tokë sikur që po e bëjnë shumë qytetet tjera. Ka qenë shumë e lehtë dhe është shumë e lehtë me marrë modele. Atëhere kur nuk dimë me marrë modele që Ferizaji nuk është marre me shku me kqyr si bëhet zgjidhja se si duhet me ja mundësu qytetarit qarkullim të përhershëm dhe të lirë. Është interesant se si po heket kjo baza e vjetër diku afer 1 meter zhavorri me u shtru bazë e re, po qajo baza e vjeter ka vite të tëra që është rrastu, dhe d.m.th nuk levizë kjo e reja që po bëhet, sigurisht që ka me levizë se flen ajo pak. Nuk e di bile së paku qatë bazë pse po e hekun është shumë me u quditë, ata janë inxhinera e dinë më mirë. Unë nuk e di, mirëpo logjika e shëndosh, baza që ka fjetë është në rregull me punu. Kam dhe disa kërkesa, njëra

ndër to është tek vorrezat e dëshmorëve. Një pjesë e parkingut, asfalti është prishë, po kemi probleme dhe kur po shkojmë me i bë vizitat tek varrezat e dëshmorëve aty. Pak punë ka, po zgjidhja është shumë e madhe. I njëjti problem është tek rruga e Goshicës, ajo farë pushimorja e busit që i merrë udhëtarët me vite të tëra ka mbetë ashtu me pak punë ajo mundet me u rregullu. Edhe një kërkesë tjetër tek fusha sportive e Gërmovës, aty mbrapa është një kand që është shumë i pashfrytëzuar, është mirë të bëhet parking për makina, sepse vynë për jetën e përditshme e sidomos në kohën kur po mbahet turnini tradicional që është Milam Tahiri, aty do të ishte zgjidhja ideale dhe d.m.th është zgjidhje e përhershme dhe e mirë.

z.Jakup Demiri: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Edhe nga parafolësit shumica e pyetjeve aty sillen dhe nga unë. Kam një pyetje për kumunën, d.m.th punimet në qyteatin e Vitisë, kemi pjesën e sheshit në qendër, kemi rrugën e lumit pa u kry dhe është bërë një far kaosi. Kur të punohet edhe bëhet kaos dorën në zemer është e kuptueshme, por qysh punohet në komunën tonë pa i respektu të paktën edhe në aspektin moral të diskutimeve marohet sheshi i Vitisë. Ne si kuvend komunal nuk dimë kurgja apo takime me qyteaterët atë që kanë me shfrytëzuar me pasë me ditë. Unë kam një kërkesë prej taksistëve. Nuk e dinë se çka kanë me bë ata taksist, ku kanë me qenë. Tjetra, problematika është ish kubzat, ato a hudhen diku a ku janë, ku gjinden. Tjetra, kur kryhet e ditë kur kryhet. Tjetra është edhe tek rruga, se edhe Taulanti foli për rrugën me kubza, kalldrëm atje, por a do të jetë e vendosur, a do të jetë e kufizuar tonazhet që do të qarkullojnë aty pari? A i keni diskutu këto gjëra me orë? Mirë që këtu është një praktikë që, në momentin e fundit nesrit kanë me dalë me fillu punimet. Ndryshon plani, ndryshojnë planet. Tani aty nuk ka kohë me bë matje inxhinierike, as matje të gjërave të tjera që e prekin qytetarin, lëvizjen, aktivitetin, zhvillimin, të gjitha. Edhe vetë Vitia si qytet është një qytetëz e vogël, e cila nuk ka pjesë tjetër edhe këta po e bajm shesh krejt, edhe po bahet një qytet si turistik. Dyqysh jo më shumë këtu flitet për zhvillim ekonomik e për shumë gjëra, po kur të bisedojsh me njerëz është njëfar hutie e madhe, do të thotë këto i kam, ndërsa rruga mbas lumit është ka shfrytëzohet rrugë 2 kakshe. Fillimisht ne prej se është bërë 2 kakshe ne nuk kemi reagu, por po reagojmë me sjellë në kuvend ta kalojmë formalisht. Nuk është ndonjë telashe, nuk e pengon askush, bile me bë se vendim të rrugëve, por ndryshim të kahjeve i jep kuvendi komunal. Është punë e thjeshtë, veç me pru me kalu, por kjo po kalon në një far joserioziteti për hajgare, çka dojmë bajna. Po me dal një policit me ju m' tek i denon qytetarët, se ai atje planin e veprimit të automejteve të rrugëve e ka ndrysh. Po e quditshme se, unë e di që komuan e ka pas bë një vendim për nja 12 vendparkinge për taksista, por i kanë pas dënu policia taksistët, i denojshin përditë, u ankojshin, edhe ajo nuk ka pas kalu këtu në kuvend, polici kur dojke dalje denojke kanë dojke e denojke kanë dojke jo. E kështu është mirë me kalu ne atë në kuvend, bile nëse ka mundësi sot ose në seancën tjetër, që mos me lanë më shumë. Më mirë është me pas vendim sesa pa vendim.

znj.Lindina Demelezi: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Dëshiroj të terheq vëmendjen tuaj mbi gjendjen e trotuareve nëpër fshatra, të cilët janë të dëmtuar dhe paraqesin rrezik për kembësoret, veçanarisht për fëmijët dhe të moshuarit. A ka plane nga komuna për t'i riparuar ose renovuar këto trotuare në një të ardhme të afërt? Nëse po, kur pritet të fillojnë punimet dhe cili është afati i përfundimit të tyre? Pyetja tjetër është lidhur me ndriçimin e rrugës Pozheran – Sllatinë. Ndriçimi kësaj rruge ka mbetur i pa përfunduar që një kohë të gjatë dhe kjo situatë ka sjellë shqetësim dhe rrezik për banorët e zonës. Kam bërë kërkesa të përseritura në asamble lidhur me këtë çështje, por deri më tani nuk kam marr përgjigje. A mund të më informoni se kur pritet të përfundojnë punimet për ndriçimin e kësaj rruge dhe cilat janë hapat e ardhshëm që komuna do t'i ndërmarr për zgjidhjen e këtij problemi? Nëse nuk vazhdojnë punimet nga komuna, atëherë po fillojmë me vetëiniciativën e fshatarëve që t'i përfundojmë ato.

z.Musli Neziri: Përshendetje për të gjithë të pranishmit? Unë kam 2 pyetje si parafolësit thuajse. Pyetjen e parë e kam rreth punimeve në oborrin e shkollës fillore në fshatin Sllatinë të Epërme. Aty është ndërhy në disa punime që është heqë bazamenti komplet i sallës dhe jam i interesuar të di se pse ka pas nevojë me u heqë kjo. D.m.th, ne e dimë që temelet qysh moti, tash u heqë krejt. Më shumë po du sqarim rreth kësaj çka ka ndodh aty. Dhe pyetjen tjetër e kam për renovimin e shkollës së gjimnazit. Kur pritet të përfundojnë ato punime? A pritet që në shtator të fillojnë në objektin e gjimnazit nxënësit që janë pjesë e shkollës së mesme “Kuvendi i Lezhës”, gjimnaz Viti? Sepse e dimë që na ka qregullu orarin e procesit mësimor. D.m.th në shtator a pritet që të fillojnë aty nxënësit mbajtjen e mësimin?

z.Nexhat Halili: Përshendejte për të gjithë të pranishmit! Unë shpesh në seanca e kam potencu rregullimin e trotuareve në Komunën e Vitisë në disa projekte rreth trotuareve në Komunën e Vitisë kan filluar së implementuari, mirëpo këto projekte kanë mbetur në mes të rrugës, gati se në fazën fillesatare. Nënkrjetar, a keni ndonjë plan se kur do t'i përfundon këto trotuare. Shumë rrugë shihen herë herë duke punuar, mirëpo vendosen kockat dhe skajoret në rrugë. Ka raste që e pengojnë edhe komunikacionin. Nëse e keni ndonjë plan tregoni se a do të përfundoj. Dhe ju lutem, të dilni pak në teren dhe të shihni trotuarin se si është gjendja e tyre. Pyetja tjetër ka të bëjë me drejtorin e shërbimeve publike, rreth pastrimit të rrugëve nga barishtet, shkurret. Nënkrjetar, pasi drejtori nuk është preznet po të drejtohem ty: a ka ndonjë kontratë ose ndonjë plan se kur do të filloni pastrimin e këtyre rrugëve, sepse tani gati veç se erdh sezona, ku mërgimtarët vijnë dhe tash janë prezent në komunën tonë. Vetëm du me ditë a keni ndonjë plan se kur do të filloni për pastrimin e këtyre rrugëve. Dhe një pyetje tjetër. Komuna e Vitisë ka problem me ujin e pijshëm. Gati se në të gjitha takimet kryetari i komunës ka premtu se do të ketë ujë të pijshëm dhe do të punohet në këtë drejtim. Në këtë drejtim është instaluar edhe ujësjellësi i cili lidhë 5 fshatrata, Tërstenikun, 2 Sodovinat dhe 2 Sllatinat. Mirëpo uji nuk është i pijshëm, nuk është i përdorshëm. Ka raste që ky ujë edhe për pastrim nuk përdoret kur ka të reshura atmosferike. Pyetja ime është decidive: a ka mundësi të gjindet ndonjë burim tjetër për me implementu këtë projekt që në të ardhmen fshaterët të kenë ujin e pijshëm?

znj.Milicate Ajeti, drejtoresha: Përshendejtje për të gjithë të pranishmit! I nderuari Ali, menaxher i kësaj kontarte. Është një kompani e kontraktuar për menaxhimin e këtij projekti, është Besim Imeri dhe Mediana Bislimi. Mjetet 142 mijë euro, pak para se me përfundim viti i kaluar kan qenë që na e kanë qitë mjetet dhe tash gjithsej krejt janë 1 milion e 16 mijë e 252.86 euro, jan mjetet të ndara për komune tonë.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Përshendjtje për të gjithë të pranishmit! Do të bëjë përpjeke, megjithatë kam mungesë të informacionit, sepse shumica prej pyetjeve jan drejtu në adresë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike të cilat drejtori të shërbimeve publike sot është me një udhëtim zyrtar në zëvendësim të drejtorit të bujqësisë për verifikim të subvencioneve të cilat kanë me marrë mekanizmin bujqësor. Këshilltari Ilir Zuka lidhur me ndriçimin publik, si shqetësim çështjen e rregullimit. Unë besoj se do ta ngris, se shumë here e kam ngritë, shumë here ka pas sukses, shumë herë ndoshta nuk ka pas degjueshmëri, por megjithatë do ta ngris çështjen e pastrimit të aborrit. Ke drejtoresha e shëndetësisë, por besoj që kemi ne disa punëtorë dhe besoj që urgjentisht do ta jap si kompania e cila e ka mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe do ta urdhëroj që me shku me ja dhanë tretmanin si e meriton një QMF në Pozheran. Sa i përket z.Alisë, debat me qyteatërit. A është e mjetueshme 4-ër, ndoshta duke pasë parasysh çështjen e performacës të cilën me të vërtet ata nuk po e shënojnë numrin e debateve, por pe shënojnë numrin e ballancin gjinor. Jemi fokusu në 4, tu e përjashtu 1 sivjet Smira, që me insistimin e kryetarit do ta ketë një që nuk bjen në kategorinë e tyre. Nuk është debat për buxhet, por është për shkak se do ta kemi një debat me qytetarët, se në bashkëpunim me USAID-in, kryetarit të komunës ju ka preferu që ka pëlqy 1% e buxhetit të investimeve kapitale të ndaj për një lokalitet dhe kryetari i Komunës së Vitisë e ka zgjedh Smirën, që do ta kemi në Smirë. Është caktuar edhe data kur do të jetë dhe aty bisedohet tash për 35 mijë euroshin, se në rast se i kemi 3.5 milion investime kapitale, 1% dhe aty do të debatohet lidhur me 35 mijë euroshin ku do ta orienton Smira, dhe në fund preferohet me pas 1 javë me votu dhe cili projekt fiton ai realizohet, ndërsa këto 4 janë të gjitha, se ligji thotë 3 minimum. Ne i kemi bërë 4, besoj jemi në përputhje me ligjin. Taulanti ka bërë shumë pyetje, por i ka shtu 2 çështje, sheshin dhe rrugën e kalldrëmes, që në kuader të saj ka bërë shumë pyetje. Taulant, nuk ta themë politikisht, ta themë që nuk përzihem kurr që janë çështje të ekspertave. Me profesion jam jurist, dhe a është ma e mirë kjo kockë apo ajo e vjetra duhet me dhanë ekspertët që duhet me qenë dhe një komision për pranim, dhe ata e mbajnë përgjegjësinë, orientimin e keni dhanë ju, d.m.th kur e keni aprovu buxhetin që me u rregullu sheshi dhe tash kualitet kërkon vazhdimisht. Unë jam për me kërkua kualitet. A ka pas qare pa ndodh, se një ditë ka me ndodh, a tashti a në gusht apo shtator, pa u prishë nuk rregullohet. Vitia është në panik. Nuk pajtohem, se nuk është në panik, se ka fjalë, ty ndoshta disa idhtar të thonë panik, neve na thonë hallall ju koftë çka jeni tu punu në Viti, megjithatë krejt këto unë besoj që janë tu bërë për të mirë. Tash sa ja kemi qëllu, së bashku me juve do ta dëshmoj koha, por me siguri që po. Çështja tjetër ndoshta vonesa e kalldrëmave është bërë pikërisht tek kjo, deri sa kompania e cila ka qenë projektuse e projektit ka thënë që në këtë formë duhet me shtrua për me pa të drejtë me kalu mjetet e rënda, se në rast se bëhet që pe quajnë iberçuk apo gjysmë betoni aty po kufizojkan mjetet deri 3.5 deri sa i ka bind dhe injinerat tanë dhe ka fillu tash. Unë nuk

guxoj me të dhanë garancion se nuk jam ingjiner për me matë atë që a do të jetë i qëndrueshëm apo nuk do të jetë, por unë kam marrë me shkrim se do të jetë i qëndrueshëm dhe duhet me shtrë në këtë formë. Unë besoj dhe shpresoj se edhe “Euro Abit” i bëhet zgjidhje, derisa ai pajiset me leje. D.m.th krijojmë ne mundësi alternative të bartjes së materilit dhe besoj që ajo çka është me rëndësi janë punë me intenzitet të lartë për me përfunduar sa më shpejt. Tash a guxoj me tu lidhë në afat me thanë në këtë datë ka mu kry, nuk është çështje e mejeve të pagesës me thanë ka me ta kry borxhin në këtë datë, megjithatë po i shef ti që po punojnë me intensitet të lartë dhe besoj që kanë me kry në formën më të mirë të mundshme, nuk ka me ndiku në atë kollapsin që kanë me ndiku bizneset, bizneset krejt të frekuentume të ti bash nuk ndikon hiq e te plotë tjerë. Ne mundemi me thanë politikisht se të vënë ty politikisht me thanë qashtu, thujem. Unë po ta marrë, por qashtu nuk është e vertet, është krejt diçka tjetër dhe sa tu kanë lajmru ty për keq, një 10 -15 fish na u kanë lajmru na kan thanë që hallall ju koft se jeni tu punu mirë. Këtë duhesh me pas të kuart. Sejdë, unë e di edhe kur e ke pas propozu këtë parkingun nëntokësor, ende nuk janë pjekë kushtet. Kur them nuk janë pjek kushtet, jo që nuk janë pjek, por ende kapacitetin si Viti ndoshta nuk e kemi aty. A është zgjidhje, unë konsideroj po. A e kemi të rregulluar çështjen e kanalizimit të bartjeve të ujit e kam fjalën thujse Viti është vend ujqor edhe nëpër podrumet. A kemi mundësi me bartë atë, nuk po të themë po, jo, por duhet me thanë ekspertët, por një zgjidhje mirë ish bërë edhe ish kursy një sipërfaqe bukur e mirë e qytetit dhe e tokës. Unë besoj që çdo qeveri nuk duhet me i kry krejt punët, duhet me ardh dhe qeverit tjera dhe me vazhdu. Shqetësimet që i ngrite 3 çështje, plotësisht do t’i ngris edhe unë, ta shofë a mund me hy këto në mirëmbajtjen e rrugëve verore që i kemi dhe dimërore, se masi është mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve mund me kalu te stacioni që e përmende në Goshicë mund, ndërsa atje në Gërmovë tash nuk e di sa është ajo sipërfaqja. Unë nuk po e di tash a mund me hy në këtë kontratë si mirëmbajtje apo duhet me u bë një projekt i vogël i cili mund me u kalu. Plotësisht pajtoj Jakup kur thu që vendimi duhet me ardh në kuvend rruga 2 kahjore, se pjesa dërmuese lidhen me Taulantin ato pyetjet tua. Unë kam bisedu me drejtorin e inspeksionit, ka qenë para shkuarjes penzion duhet me faleminderu se ishte puntor i madhë por ishte qështja e penzionimit dhe nuk e pruni për kuvend duhet me ardh se kuvendi është ai që vendos ne ende nuk e kemi bërë inspektorin e komunikacionit e kemi bë tash drejtorin e ri e ka një problem familjar që ndoshta ju e dini që ndoshta nuk po mundë ta ngarkon njeri me punë të cilet i ka në përshkrim të rendit të punes që uroj dhe një ditë të i kthehet normalitetit dhe ai dhe ne ta rregullojm atë qështje se plotësisht vrejta është me vend se një vendim i keq i kuvendit është më i mirë përshkak se ka marrë një shumicë dhe duhet të respektohet. Lendit qështjen e trotuareve këtu e ka ngrit dhe kryesuesi unë e kam ngrit para inxhinerave i kam ngrit në smir 2 raste që mi ka paraqit që janë hapsira të vogla por që meritoj tretman rregullim të tyre në rastë se është fjala për ato unë besoj se ka me ngrit dhe qështjen me sllatin, ndërsa tek qështja e ndriqimit të rruges iniciativat e qyteatreve nuk ndalen askush nuk i pengon dhe në rastë se ndriqoni veq mundem me ju faleminderu aty nuk është problematik që nuk ju pritët i rregullon dhe hecni përparpa, punimet në oborrin e shkolles fillore besoj mus edhe në atë kohë kam ngritë shumë ka qenë si shqetsim ajo bazë edhe nuk ka pas kompani që kish guxu me ta marrë me ta ndreq palestren mbi atë bazë nuk ka pas as dokumentacion prandaj ne nuk kemi dashtë me polemizu atë qështje duhet diçka e qëndrueshme me qenë në atë bazë dhe nuk ka diçka që kena dashtë em qitë model të ri por gjithëhere projekti duhet me qenë i qëndrueshëm nuk e di a e ke pa që pllaka nuk ka pas as armatura përpyet që nuk e ke ditë as lidhja qysh u ba ne ti kalon të shkuarës dhe duhet të besoj që konform standardeve të ndrtimatis të ndërtohet. Kam qenë në takim vitin e kaluar ku i kemi marrë klast shkolles profesionale teknike që është me faleminderu dhe mirekuptimin e juaj dhe të shkolles fillore dehsmoret e Vitis dhe e di që atëherë është tahnë që këtë 3 mujor të pushimit ëprfundon gjimnazi dhe ka me ju kthy normalitetit qashtu ka qenë fjala tash më nuk i kam pyet po në rastë se ti je i interesum edhe më obligon unë do të intersohem dhe do ta pyes kompanin veq qështja un kan se duhet me u perfudnu në këtë 2 mujorsh të pushimit në formë që me 1 shtator gjimnazi me ju kthy noramlietet por edhe ju shkolla profesionale Jonuz Zejnullahu. Nexhat trotuaret ndoshta nuk e ke bë qëllimisht a kan plan nuk ka sen që bëhet pa plan se ti e dinë se ke punu në zyre të prokurimit në fillim hapja e tenderit mu bë ti pa plan nuk bëhet dmth kan tash a kane dhe afatshmeri të perfudnit të punimit kan a është tejkalu nuk e di unë e pata përdor 2-3 seanca një sistem që me qenë këtu zyrja e prokurimit zyrja e personelit dhe inxhinerat po tani ju vetë më thaë mos i bini më gjithë here kam mendu përshkak pyetjeve që i bënë që munden me qenë më adekuat se nënkreatir apo kryeatri nuk mundë krejt me i ditë por referatet të cilet mirren me atë qështje dhe që munden me u shtrë pyetjen i dinë gjithsecili ato të vetat më detajisht. Pastirmi i rrugëve me

barishte pjesen dermusee e kam parë që e kam kry ndoshta ato gjithë here zhvillohen dhe kam nevoj për mirmbajtje është mirë me cekë me rrugë cila është pa pastru që me ju drejtu drejtori i sherbimeve publike dhe me kry gjithë ehre e kam fjalën për rrugë të cilët janë në domein tonë. A po punohet në këtë drejtim në ujë të pishem Nexhat ti ndoshta ke qenë larg situates përshkak pozicionit që punon krejt teter kund, shumë kom hargju për ato 5 fshatra e kam ndij obligim edhe tash jam tu hargju shumë në kemi formu një komsion dhe ka dalë e ka bë një ingjizim detaj seqka nevojitet kemi aps shumë pegnesa përshkak që u nevojitet një ingjiner i elektros më teper kam dhanë vrejte të aspektit defekte të cilët janë në ujesjelles fshatra kanë dhanë në aspektin elektrik janë në perfundim për me shpall tenderin aty bjen dhe Zhitia dhe do të rregullohet ajo qështje dhe ju kaloni në menagjim të hidromarves qështja e kualitetit të ujit në momentin kur kalon në menagjim të hidromoraves e merrë dhe instituti për shendet publik që e kontrollon dhe nuk e kemi bisedu kurr qështjen e ndrrimit të burimit po jam shumë i sinqert përshkak se momentin kurr e merrë hidromorava do të ketë një ujë të kontrolluar dhe momentin kur të thojn ata që prej kësaj date kur të dalinme lajrmim nuk pihet do të jeni të informum dhe gjithq rregullohet, krejt me rendesi është me mujtë me rregullu që besoj që ajo së shpejti ka me u bë përshkak se jemi në perfundim dhe këto 5 fshatra dhe zhitia ka me qenë në rregull, cila kompani ka me marrë me i kqyr këto defekte do ta shohim.

z.Taulant Haxhiu: I nderuari nënkryetar, dëgjo, politikë nuk jam tu bë, por ty të bjen në Viti me shku në zyre tande në ora 8 dhe në ora 4 kthehesh në Remnik, në fshatin tanë. Unë jam qytetar i këtij vendi, jam qytetar i Vitisë, edhe qytetarët e Vitisë i dinë hallet më mirë se të disa fshatrave. Ti i din punët e Remnikut më mirë se unë, por edhe unë brengat e qytetarëve të Vitisë i di më mirë se ti. Veç bonu i sinqertë, në shtëpinë tande a e kishe leju këtë me bë me kalldrëm që e kanë bërë. Mbrapa këtë kalldrëm që e kanë shtru sot në shtëpinë tënde a e kishe leju?

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Po more!

z.Taulant Haxhiu: Jo kurrë! E dyta, si nënkryetar i komuës nuk po ki informacion me na tregu se ka do të jenë rrugët anësore që do të kalojnë qytetarët. Mu kjo po më brengos më së shumti, ka do të kalojnë qytetarët. A e din sa qytetari vjen në Komunën e Vitisë pas 14 dite këtu, edhe në Remnik të shtohen mbi 1 mijë banorë. Veç kallxom qytetari i Vitisë ka do të kalon, ka do të shkon. Infomatë po du, me na tregu ata me ditë beso që televizioni plus asnjëhere nuk ka njerëz onllajn më shumë se sot tu e percjellë këtë seancë, se kanë problematika. Unë duke fol me ty, një banor i atyhit që çka më dergoj. Tha që 1 javë ditë nuk është tu punu te rruga me kalldrëm, ata janë banorë. Nuk po e di te cila ndërtesë ka më shumë banor se kjo ndërtesa që është te “Euro Abi”, ku po shtrohet kjo rruga me kalldrëm, ka me hec ky, ka me i qu fëmijtë në shkollë. Me pas dikan të smut, ka me levizë? Tash ma dergoj. Për bizneset që po themë nuk jam tu bë politikë. Nënkryetar, çdo mërgimtar që vjen prej vendeve të ndryshme të Europes, ai e ka për synim qendren, sheshin. Ai shkon në qendër, ai as nuk shkon te komuna e re, as te stacioni i autobusëve, se nuk i duhet. A ta merrë mendja se këtë rrugë prej te pasqyrja që u blloku e deri te “Rio” janë diku 200 punëtorë që punojnë, 200 biznese që operojnë a po ta merrë mendja që qytetari hinë këtu nëpër këtë katrahuren e komunës edhe shkon me kry shërbime me ble diçka, me marrë diçka. Jo, e ka alternativë Gilanin, Ferizajn. Unë ato që i thashë nuk i thash politike, po ta themë ty, të kam thanë edhe atëhere, ka me të nxan sezona, ka me qenë e bllokume Vitia. Në qoftë se këto biznese që operojnë në këtë pjesë ka me pas regres të qarkullimit në krahasim me vitin e kalum, dihet që fajtori kryesor është komuna me projektet e ngadalshme. Qe 1 javë nuk është punu te rruga me kalldrëm. Nuk bëhet more projekti me 750 mijë euro, 800 mijë euro me 3 punëtorë. Unë po të drejtohem ty, se je adresa e vetme këtu që muj me tu drejtu, unë po e shofë që ty po të duket pushteti krejt me lula, po duhet kaniher me ja ngu brengat edhe hallet e qytetarëve. Nuk jam tu bë politikë, beso që nuk jam tu bë, vetem informona se ka do të ketë alternativë në sezon korrik dhe gusht qytetari me kalu me kerrë. 15 deri me 17 korrik, 15 mijë deri 20 mijë banorë janë më shumë në komunën tonë.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Shiko Taulant, unë po të themë politikisht po e thu se krejte e dinë se ka kan me kalu rrugët që janë të mundshme në Viti pas shtepis kultures këtu që je ajo tjetra që e kemi bërë 2 kakshe këto i dinë ti, a e di unë Vitin a ti e dinë 24 orë bënë vaki rrinë edhe 48 orë edhe nuk e meson këtu, 8 orë unë i degjoj të gjitha brengat nuk ka mundesi shanc a mundë më shpejt me u kry është qështje tjetër pa u bë ky nivel pa u prish pa u blloku një ditë nuk ndreqet, e dyta sa banor i ka Vitia dhe sa i ka jashtë besoj e di më mirë se ti me shifer ta japë. Është një realitet që rritet dhe nuk ka shqiptar në Kosov që jeton e që nuk i gezohet kësaj rritje edhe që nuk e prit këtë ditë por unë po shpresoj dhe po besoj se veq kan fillu tppart nuk jam tut thanë politikisht taulant jam në gjendje

me të ingjizu që vinë plot dhe ju gezohen vendpunishteve që jan tu punu ka dikush që ndoshta e pengon por ka dikush prej botes jashtme që vjen thotë hallall ju koft se ish bë sikur në zvicër qdo kund vendpunishte po punohet dhe kesaj duhet me ju gzu në rastë se ti nuk ju gezohesh kësaj qështje si kshilltar i kuvendit komunal dhe si aprovues i bugjetit është brengosese e tash në qështjen e përsheptimit edhe unë pajtohem është mirë me ju thanë që me kry sa më parë që besoj nuk ka takim të cilet nuk kerkojm persheptimin epuneve rritjen e numrit të puntroeve që me perfundu më parë a për qështje që shohin tu punu nuk ka njeri që nuk ju gzoher.

z.Taulant Haxhiu: Nënkrjetar, unë ju gëzohem se unë e kam votu, po unë po du me ditë çka bami me hallin e tyre. Tash e ki të bllokume te pasqyra te posta, e ke permbas "Home Cake", 600 - 700 kerre ka levizin, ka shkojnë, ka parkohen, po nuk janë të mjaftushme o nënkryetar, edhe unë ju gëzohem, por po të themë që është bërë keq, nuk foli këto fjalë që jam tu i thanë unë, ishalla jemi këtu pas sot 1 vjet, që nuk dalin qeshtu unë të kam borgj ty si po të themë unë decidiv, po të themë jam tu fol shumë sinqerisht dhe me shhpyrt, nuk jam tu folë me bë puro politikë, se di me bë edhe puro politikë. Qytetarët i keni blloku, ata nuk po kanë informacion se çka do të bëhet. Nuk jam kundër projekteve unë, veç kallxom alternativën në korrik dhe gusht, kallxom ti mu sa do të vanohen punimet, kur do të përfundojnë këto punime. Unë këto jam tu i kërku prej teje. A që nuk ka qef Taulant Haxhiu, kam qef shumë, por ata kanë breng. Po më shënojnë, ka do të sillen ata, është e pa mjaftushme kjo rrugë që ja keni kriju sot. Ata që bajnë sherbime dhe mallra, hajt tregom dikush që ka diçka me ngarkesë të rëndë ka do të kalon? Një shleper p.sh.: po du mobile në qendër ku e kam pas unë ish banesen tem. Banesa jem ka qenë këtu te Florenti nalt, unë kam jetu aty, kam lind aty, kallxom ka me hy aty i nderuari nënkryetar i Komunës së Vitisë. Që 12 vite, gati as Sali Berisha nuk ka qenë më shumë.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Jo nuk kanë qenë qytetarët që kanë thanë qashtu, nuk është problem. Nuk është problem ti me i bajt 10 metra më larg edhe për tjetër. Asnjë çështje këtu nuk ka të pazgjidhur.

z.Taulant Haxhiu: Jam tu fol në bazë të ndjenjave, nuk jam tu fol i përgatitur, jam tu fol si qytetar i Vitisë. Unë jam nga Vitia, kam lind e jam rritë në Viti, alternativë nuk kemi. Ka hi projekti pa ndonjë projekt të detajizum. Ka hi hajt ti krymi puntë, çka bëhet me qytetarë nuk dimë. Na po himë në projekt, po e jeshojmë këtu përpara, po çka të bëhet, alternativë nuk kemi, ngulfatje. Unë kështu po e shof prej perceptimit tem.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Taulant, je tu e pa shumë gabim. Ti alternativën e ke me hy në banesë, e ki 10 metra më larg. Ti po e thu një qytetar. Unë po ti themë 1 mijë që janë tu e thanë hallal ju koft. Kubzat janë grumbullu, e kanë formu një komsion prej 3 vetave dhe kujtoj me lokalitet 650 metra, 500 metra qysh më kanë raportu nga kërkesat që janë bërë, janë dhanë që destinohen për hapësira publike. Ata që kanë shtru kërkesë në komison, ekzsiton prej 3 vetave.

z.Taulant Haxhiu: Nënkrjetar, gjysmën e kubzave nuk i ke aty, kejt kompelt do i kan marrë pa asnjë argument i kan marrë. Unë po të tregoj, unë po të themë që jam qytetar i Vitisë. Në qoftë se i ke kubzat, ti sa i ke hekë e i ki aty, unë të kam borgj.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Unë e di që i kam.

z.Taulant Haxhiu: Hajde shkojmë me qëta çka i kanë hekë dhe si ti kish unë të jap përgjegjësi para këtyre. Po të themë, në qoftë se i ke këto që i ke hekë këtu, hajde shkojmë e thirim këtë projektusin që i ka kry punët, i thojmë, zotëri, sa i ke hjek këtu sa i ke atje.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Unë mundem dhe me keëku infromatë, se unë kam formu komision. Në momentin kur konstaton që ja i ke ja nuk i ke, ti nuk je korrekt. Ti për me qenë korrekt duhesh me thanë: >>nënkryetar, këto kubzat e komunës dyshoj që janë shku krejt në vende tjera. A e ke formu komisionin? Po. Bire një informatë në kuvend, unë ta sjellë<<.

z.Nexhat Halili: Nënkrjetar, është i vertet që çdo projekt e ka planin e manxhimit dhe planin dinamik, se deri kur do të përfundojnë, mirëpo trotuari i cili i lidhë 3 fshatra, Tërstenik, Sodovinë e Muhaxherëve dhe Sllatinë ka fillu gati qe 2 vite, ende është në fazën fillestare. Për atë unë bëra pyetje, kur do tëi vije fundi këtij trotuari. Unë nuk po mohoj që nuk ka pastrim në disa lokalitete, mirëpo në disa lokalitete sidomos ka vij unë nuk po shof që ka pastrim të rrugëve prej barrojave, nuk i kam parë. Ti nëse ka kontratë, besoj që ndoshta në të ardhmen i pastrojnë, mirëpo për momentin, edhe tash kalova nëpër fshatin tim nëpër Sodovinë të Muhaxhereve nuk pash që janë të pastrume këto rrugë.

z.Illir Zuka: Kryesues, ne e kemi nxjerr një rregullore po e kemi bënë një marrëveshje të pashkruar. D.m.th, që secili asambleist t'i ngris 2 pyetje. Edhe kesh prej të parëve që morra fjalën dhe respektova deri në pikë të fundit, përndryshe, sa kërkesa, sa pyetje kam prej qytetarëve. D.m.th krejt këto pyetje jasht rendit ditës mi bë këtu sun i mbuloj. Uroj që herave tjera, d.m.th të jemi të njëjtë krejt, se përndryshe po lidhem te nënkryetari. Lus nënkryetarin, që njëmend me u marrë me ndriçimin në Pozheran, se kemi jashtëzakonisht probleme të mëdha. Kam edhe 2 shqetësime të vogla. Prita prej Nexhatit në Tërstenik që po e ngrit, unë e di që e kanë bërë kyqjen prej ujës-jellësit nëpër shtëpi kanë jashtëzakonisht probleme. Shpiat në Tërstenik që i kan vnu gypat, a dopt dhe po ju pelcet nëpër shtëpi ujës-jellësi. E din Nexhati sakt këtë problem, po nuk dashta me u marrë me të për shkak që vjen prej atij lokaliteti. Prita që po e ngritë këtu. Edhe tjetra çka pata është kjo pjesa pas shtëpisë së kulturës. Në qoft se është mundësia kjo mu bë dykakshe për lidhjen e qytetit. D.m.th për shkak mos me shku deri në fund, këtë rrugë mundemi me bë dy kakshe dhe me u lidhë për qytet.

znj.Lindita Demelezi: Nënkryetar, ne e bëjmë edhe me vetë iniciativë, po ju kisha lutë që mos të vini të bëni foto se nuk jeni të mirëseardhur për ndriçimin që the më herët. Sa i përket trotuarit, nuk është fjala vetëm për trotuarin në Smirë, por është fjala për të gjitha trotualet. Dilni në teren dhe shikoni të gjitha.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Linditë, unë e mora shembull thashë, në komitet e ka ngritë, po thashë në vazhden e saj unë nuk përjashtova, nuk më paske ndegju. Unë thashë në KPF këtë çështje e ka ngritë edhe kryesuesi për rastin në Smirë, që po e përfshika dhe Sllatinën, që përmirësohet. Unë thashë po nuk më paske ndegju. Për çështjen e fotove. Mos të pengojnë ty si mos të jeshë ti aty, d.m.th nuk cenohesh ti kush del në foto dhe ku delë, është çështje e lanë qytetarët për punën e vetë që ka kry, ti delë e kryen atë punë. Në rast se i kryen ato punë e vendos ndriçimin, dil në foto mos u ndal hiq, nuk të kontestojmë.

znj.Lindita Demelezi: Nënkryetar, sa herë e kam ngritë këtë çështje nuk mu keni përgjigj. A kam kërku përgjigje me shkrim, me post elektornike edhe nuk më jeni përgjigjur për këtë arsye se ka mbetë një pjesë e shkurt.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Po de po, nuk e ke qëllu edhe pyetjen çka me tu përgjigj kur nuk mund e qëllon, çka me të bë. Ti si të jesh këshilltare e kuvendit komunal duhesh me i ditë kompetencat e tua, ti je aprovuese e buxhetit dhe ti delë jashtë aprovimit të buxhetit bënë më vonë kërkesa, ato shkojnë në ajër, nuk kemi çka diskutojmë. Ti je ajo që ke aprovu buxhetin në kuader të aprovimit të buxhetit që ke bë. Në rast se ti shtron pyetje se ke kry këtë e ke aprovu buxhetin, këtu është përgjegjëse egzekutiva. A tani çka të thojnë qytetarët, çka janë kërkesa me i pas edhe 20 milion mjete të investimeve kapitale nuk mundesh me i kry.

z.Musli Neziri: Nënkryetar, thatë se në fshatin Sllatinë e Epërme që nuk i ka plotësu kushtet ata, as unë nuk jam inxhiner me vlerësu atë pjesë, po kjo pjesa që është bërë punë dhe nuk është bërë sipas standareve, unë mendoj që u dashtë ndoshta më heret me marrë përgjegjësi dikush që nuk e ka kry punën qysh duhet, ndoshta janë vonu në atë pjesë. Te pjesa e shkollës, Gjimanzit, thae se u zotu ajo kompania se ke marrë pjesë aty. Është mirë me marrë atë informatë, se thave që muj me marrë ndoshta informatë që në shtator është shumë e rëndësishme. Besoni që kemi pas shumë problem nga aspekti hapësires, mbajtejes së procesit mësimor. Është shumë me rëndësi për vendin, për Vitinë, që ajo shkollë me mujtë me fillu në shtator. Unë nuk kam shku me vizitu, por ju jeni nivel ekzekutiv, mundeni ta vizitoni, kërkon përgjegjësi se ku kanë mbri punimet, besoj që në seancën e ardhshme ndoshta është interes ta dimë me të vërtet a do të fillojnë nxënësit mësimin aty.

z.Ali Bajrami: Drejtoreshë, rreth përgjigjes një plotësim shtesë. The që është kompani profesionale që ka marrë dhe menaxhon projektin. A është kompani që vepron dhe operon në Komunën e Vitisë, kompani vitiase? Këtë personin që permende pe njof, pe di. Kush është personi e dytë? Një sqarim, a është banorë rezident i Komunës së Vitisë.

znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Jo nuk është. Ajo është e Gjilanit dhe merret me projekte bashk me kompaninë që janë për Gostivarin dhe neve Vitinë.

z.Ali Bajrami: Nuk ka pas kompani në kuader të komunës që ka mujtë këtë projekt me mbikqyrë?

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Nuk është fjala për mbikëqyrje. Ajo ka qenë një prej asaj që i ka plotësu dokumentacionin dhe që ka fitu projektin.

z.Ali Bajrami: Nëse ka qenë kjo atëhere në rregull, po mua nuk po më duket e arsyshme një kompani jashtë Komunës së Vitisë, se jan kan dhe 2 projekte, por kemi mujtë dhe kemi njerëz dhe ekspret që kanë mujtë një kompani

me u regjistru dhe me i marrë me i mbikëqyrë dhe këto mjete me i shfrytëzu dhe të ri e të reja vitiase kemi shumë që mujnë me i kry këto punë.

z.Jakup Demiri: Nënkyetar, deshta me ditë se e bëra pyetje. A e dini kur përfundon sheshi në qytet? Më heret nuk e thashë, tash po e thamë: pse nuk keni fillu me herët me punu diku prej fillimit apo gjysës së janarit ose fillimit të shkurtit? Sepse ka pas kohë për me punu e mos me prit këtë kohë, bile me pas qenë e kryer në maj. Tjetra, te projekti, se nuk dashta me bë më herët këtë pyetje, se është stergjatë kjo temë, ishte fjala, muhabeti i trotuareve. Po e lidhni me votim të buxhetit. Më së pari ne nuk e kemi votu buxhetin, kemi votu kundër dhe pikërisht janë këto arsytet që buxheti votohet bllanko, ndërsa kur dalin projektet nuk kanë fond të ndamë, e kjo është tani problemi, këtë e dimë, se po mundohen me i arsyetu shumë gjëra, por buxheti në Komunë të Vitisë votohet më së keqi në të gjitha komunat. Këtë mundem me ta argumentu me çka dush, se nuk specifikohen projektet. Projektet të cilat janë në Viti, deri tash ka qenë një praktikë që nuk janë specifiku në buxhet dhe problemi më i madh i imi kur votojmë buxhetin është ky, se tani stergjaten dhe ka telashe në implementim të projekteve. Kjo është përgjigja që mundem me dhanë në këtë adresë, se nuk është ndonjë politikë shumë me kundershthu e mos me votu buxhetin. Dorën në zemër tash me fol, pra me u nda dikush tek është diçka tejtër, por kur të jenë gjërat në pika ne e votojmë se nuk fiton asgjë, as politikisht. Pse nuk e voton, mirëpo kjo tani kjo loja e brendshme e kryetarit të komunës është shumë e fuqishme, tani kur i ka duart e lira me ba çka do, se një projekt i cili nuk e ka koston nuk i ka do pare të ndame, ai me doemos që ka me pas probleme, edhe çështja e punimeve në teren tregon vetë. Dilni shikoni rrugët, është për keqardhje se nuk dashta me u bë në nivel fillimisht të bisedave, por prej zyrave me të vërtet me siguri që nuk i dini si janë telashtet, por me dalë në teren me siguri i shihni. Ne e kemi dhe një trotuar që po hynë në vitin e 4-ër pa u kry dhe qaty gravitojnë gjysma e nxënësve të shkollës së Smirës. Shkolla e Smirës është diku prej mesit të 3-4 shkollave më të mëdha të Komunës së Vitisë, është viti i 3-të që po kalon në këto telashe që është pa përfundu.

z.Taulant Haxhiu: Më fal drejtoreshë, si e pat emrin Besimi, ajo vajza Mediana, ajo është motra e Majlinda Ostergllavës, tash po e di, se the Gostivar mu përzi. Tash po e di kush është, ajo është baba në Komunën e Vitisë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Për sot materialin e keni marrë me kohë. Unë ju falenderoj për kontributin e dhanë, për pyetje, përgjigje. Besoj që përgjigje çka nuk keni mund ti merrni në të ardhmen. Çështja e sheshit nuk është i miratum në kuvend, d.m.th është me grand të performances, d.m.th është jashtë kuvendit. Kjo pjesa çka u diskutu, para se të hy në rend të ditës unë po e propozoj një pikë shtesë. Nga mbledhja e kaluar i kemi pas 2 pika, ku kemi dhanë në shfrytëzim materilain. Ja u dhamë shefave të grupeve. Pikë shtesë: Propozim vendim për plotësim ndryshimin e Vendimit Nr. 01-110/03834, të datës 31.05.2024 për formimin e komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien e pronës palujtshme të Komuns së Vitisë, tek shtëpia e kulturës. Është fjala për këtë pronën që kemi kalu në seancën e kalume. Konfirmimi na u ka kthy i ligjshëm, por tash komisioni që u formu për dhenie ne shfrytëzim të kësaj pjesë këtu qka është vendimi është kthy i ligjshem mirpo na është dhënë në fund që obligohet kuvendi i komunes që të harmonizoj periudhen kohore të komisioni vlersues për zbatimin e orocedurave për dhenjen e pronës së palujtshme të komunes Gursel e Bajram Sylejmani në shfrytëzim afatshkurt prej 13 viteve me vendim parapark 0111005833 për dhenjen në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik lokalit tek shtëpia e kulutres Gurseel e Bajram sylejamni në kohë zgjatje prej 15 viteve dmth kan qenë 2 vendime tash kur ka ardhë aj vendmi parë nuk u diskutu ai ka qenë me dhanje në shfytezim ka shku 15 vite se 15 vite ka qenë kur e kemi leju tash komisioni u bë atë ditë u diskutu që tha Remzia për 10 vite tani u diskutu me bë 13 si tjerat për harmonizim tash kan mbet 2 vendime vendinmi për dhenje ne shfytezim është 15 vite komisioni është për 13 vite se ne veq te komisioni kemi bë debat nuk kemi bë për te dyat dhe tash na ka obligu me harmonizu prej 13 15 vetem ky plotesim. A jeni që edhe kjo pikë të hynë në rend të ditës? Pra me 20 pro, kunder 0, apstenim 2 hynë kjo pikë. Për sot kemi parapara këtë:

Rend dite

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Kuvendit Komunal të Vitisë.**
- 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizen Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë 2025-2027.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2023 në vitin 2024.**

4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin, ndryshimin e Vendimit Nr. 01-110/05-670, të datës 30.04.2024 për aprovimin, për bartjen e mjeteve nga një projekt në projektet tjera në shumë prej 148.376,16 Euro.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e Vendimit me Nr.01-060/01-116, të datës 01.02.2024 për këmbimin e pronës së palujtëshme komunale me pronat e palujtshme në pronësi të pronarëve Kadri (Bislim) Emërllahu dhe Agron (Ahmet) Ahmeti.**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetori të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2025.**

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pra, a jeni që të miratohet rendi i ditës me pikën shtesë? Me të gjitha votata pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Kuvendit Komunal të Vitisë

Se i kemi 2 procesverbale që janë mbajtur, a ka për procesverbalin nën a) që u mbajt në muajin e kaluar. Hapi debat. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet ky procesverbal? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet procesverbali. Tani nën **b), shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të kuvendit komunal.** Pra, hapi debat për këtë procesverbal. Pasi që nuk ka e qesë në votim. Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet dhe procesverbali b).

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizen Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë 2025-2027

znj.Milijate Ajeti, drejtoreshë: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Korniza Afatmesme Buxhetore është një dokument përmes të cilit Ministria e Financave cakton kufit buxhetor për vitin vijues (të ardhshëm) mbi bazën e të cilave kufi hartohet plani buxhetor i të hyrave dhe shpenzimeve për një vit kalendarik. E themi këtë për arsye se tek ne po edhe në shtetet e rajonit viti buxhetor përputhet me vitin kalendarik. Për vitin buxhetor 2025 Komuna e Vitisë do të ketë një buxhet prej 17.945.621 €, që në krahasim me vitin 2024 kemi një rritje prej 7.76%. Sipas kategorive ekonomike kemi këtë buxhet: Paga dhe shtesa 9.726.436.00 €, që kemi rritje për 133.502.00 €; Mallra dhe shërbime 3.172.919.00 €, që kemi rritje për 540.000.00 €; Komunaliteti kemi 300.000.00 €, që kemi rritje për 5000.00 €; Subvencione dhe transfere kemi 720.000.00 €, që kemi rritje 150.000.00€; Shpenzimet kapitale kemi 4.026.266.00 €. Edhe këtu kemi rritje për 463.962.00 €. Buxheti i vitit 2025 është rritur për 1.292.429.00 €. Numri i stafit të aprovuar për vitin 2025 është 1144. Kjo është baza që ne e informojmë Komitetin për Politikë dhe Financa dhe kuvendin komunal për kufitë buxhetor, dhe se ka fillu procesi i planifikimit të buxhetit për vitin 2025, ku ne gjatë ditëve të muajt qershor dhe muaji korrik, gusht deri në shtator, që jemi në procesin e diskutimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit sipas programeve buxhetore dhe përfshirjen e kërkesave të qytetarëve gjatë diskutimeve publike në planin e buxhetit për vitin 2025, në veçanti projektet e investimeve kapitale. Të hyrat vetanake për vitin 2025 planifikohen të jenë 1.270.127.00 €, që në krahasim me vitin 2024 është një rritje prej 240.625.00 €. Vlen të theksohet se, nga ky buxhet prej 17.945.621.00 € 92.92% janë mjete nga granti qeveritar, ndërsa 7.08% janë nga te hyrat vetanake. Për informimin e juaj, buxheti sipas grantëve, granti i përgjithshëm është 7.750.060.00 euro; granti specifik i arsimit 6.887.645.00 euro; Shëndetësia (QKMF) 1.927.784.00 euro; Shërbime sociale 155.000.00 euro. Gjithsej grantet janë 16.675.794.00 euro. Këtij buxheti i shtohen dhe të hyrat vetanake e që planifikohen të jenë 1.270.127.00 euro. Në buxhetin e planifikuar për vitin 2025, prej 17.945.621.00 € nuk përfshihen donacionet, participimet dhe fondet tjera që mund ti kemi gjatë vitit buxhetor si projeksion. Buxheti për vitin 2026 do të jetë 18.833.576.00 euro dhe për vitin 2027 do të jetë 19.996.968.00 euro. Stafit për vitin 2025 do të jetë 1144. Faleminderit për vëmendje! Kaq kisha në pika të shkurtura.

znj.Lindita Demelezi: Drejtoreshë, e keni cekur që do të bëni krijimin e sigurisë për qytetarët e komunës. A keni ndarë mjete të mjetueshme për sigurinë në komunikacionin rrugorë, sidomos tek shenjat horizontale dhe vertikale? Duke e ditur që kemi shumë mungesë të sinjalizimieve dhe po paraqesin shumë rrezik. Ju kisha lutë që ta

merrni me shumë përgjegjësi këtë sektor i cili është shumë i ndjeshëm në komunikacionin rrugorë dhe nuk e di se kush do ta marrë përgjegjësinë.

znj.Majlinda Shabani: Unë kam lexu fillimisht vizionin qeverisë për 3 vitet e ardhshme, më pastaj alternativat qeverisëse, dhe në fakt kur i shikon fushat prioritare që i kemi në kornizë afatmesme buxhetore, dalim pa vizion, pa konsistencë dhe strukturalisht jo të lidhura mirë njëra me tjetren, e mos të flasim në aspektin përmbajtësor, sepse nuk kanë mandej as përputhje logjike me realitetin aktual nga këto 5 prioritete ku thuhet që kanë të bëjnë me realizimin e objektivave e që i bie që i kontribuon zhvillimit të shërbimeve më të mira komunale. Realiteti aktual na thotë krejt diçka tjetër, sepse në anën tjetër përnjëmend i bie që, ne po jetojmë në Vitinë Europine. Vitiasit janë dëshmitar të komunës, në dështimin e zgjidhjes së problemit më elementar të tyre e ky është uji i pijshëm që një dekadë qeverisje. Nuk e kemi as cilësinë e as sasinë e ujit të pijshëm. E nëse i kthehemi kohës, vizionin për zgjidhjen e këtij problemi ka qenë dhe ka me mbetë njëra prej mashtrimeve më të mëdha të kryetarit Haliti, sepse pikërisht në këtë kornizë afatmesme buxhetore prapë jemi tu e pa që kjo nuk është prioritet, dhe pa marrë parasysh deklaratat dhe prononcimet që i bëjnë kryetari, që është tu punu në këtë djertim, ne sot po e shohim që fare nuk është tu punu në këtë drejtim. Tjetra nënkryetar, është bërë normalitet tashe sa vite që komuna jonë gjitha veprimet dhe kalkulimet i bëjnë në bazë të një shablloni. Unë po konsideroj, meqenëse është korniza e parë, është qarkorja parë dhe kemi kohë. Është mirë të bëhet një rishikim i politikave të komunës, është mirë të bëhet një planifikim adekuat dhe mu përshtat me nevojat dhe kohën, sepse unë këtu po e shoh që ne këtu e kemi edhe një problem në bazë të kuptimit, sepse ne duhet me pas të qartë se, kjo kornizë afatmesme buxhetore nuk i takon vetëm Drejtorisë së Financave, por i takon të gjitha drejtorive me digasteret e tyre dhe fushat prioritare që i kanë. E ne sot në seancën e kuvendit komunal i kemi vetem 3 drejtor prezent. D.m.th 3 drejtor dhe unë pres që në fund kur të bëhet korniza afatmesme buxhetore dhe vjenë në shtator me u votu. Unë pres që secila drejtori me i përfshi investimet dhe politikat e reja të tyre, sepse kjo i takon të gjitha drejtroive dhe jo vetem Drejtorisë së Financave, dhe këtë duhet ta kemi të qartë. Tjetra çka po du me ripotencu është që, urgjentisht duhet me u ndryshu niveli i dobët i planifikimit dhe kryesisht nënkryetar në asfaltim të cilësisë më të dobët që e kemi në Komunën e Vitisë, sepse këtu pikërisht është tu ndodh keqpordorimi i taksave të qytetarëve dhe kështu ne nuk mundemi me pas zhvillim nënkryetar. Nëse dalim me përqindje 80% të investimeve i ke në investime të forta, i ke në asfaltim dhe në anën tjetër qytetarët e Komunës së Vitisë nuk kanë ujë të pijshëm, mandej nëse flasim në aspektin llogaridhënës dhe transparent, tash e sa vite ne i kemi parë praktikën e komunës se si ka qenë në listen e investimeve kapitale, andaj sot po du me ripotencu pikërisht këtë çështje, sepse kemi kohë, është qarkorja parë dhe ne duhet me pas parasysh që lista e investimeve kapitale duhet të jetë e specifikume, sepse kemi qenë dëshmitar pikërisht e jo seriozitetit në planifikim dhe sidomos në emërtimin e projekteve. Ne e dimë që kemi parë emërtim të projekteve, p.sh.: trotuar, rrugë, rrugë me zhavorr, ndriçim publik, ngritja e kapacitetit të ujit të pijshëm të përfshirë në 15 lokalitetet, mandej çka kemi parë tjetër dhe çka shohim që e kemi dhe sot në seancën e kuvendit komunal, është bartja e mejteve financiare prej një projekti në një projekt tjetër dhe kështu është manipulimi më i madhë që bëhet i mjeteve financiare dhe këtu nuk ka transparencë, këtu nuk ka llogaridhënie, andaj kjo formë duhet me u ndryshu. Tjetra çka po du me ripotencu është që, nënkryetar unë pa dashtë me i përfshi dhe tjerat me u zgjeru shumë në diskutim, unë du me ripotencu që, duhet urgjentisht me u bë një planifiim i mirë. Fatkeqësisht unë jam tu e pa që serioziteti është tu mungu. E para, thashë drejtorët nuk i kemi prezent këtu, d.m.th 3 janë krejt. E kemi qarkoren e parë, unë nuk po du me hi edhe me garantu që as nuk kanë një me pa dhe lexu, mirëpo të paktën me pa se sa e kanë të harmonizume me politikat e veta. Edhe tjetra çka du me thanë nënkryetar që, është mirë me i lanë me një anë asfaltin siç e kam përmend në seancën e kalume dhe me u fokusu edhe në fushat tjera, me i hapë prioritete shëndetësisë, arsimit, bujqësisë. E keni blloku Vitinë nënkryetar, tërë këtë potencial që e ka Komuna e Vitisë ju e keni blloku vetem asfaltim, andaj unë po shresoj që të paktën e kemi përmend dhe në KPF që, kanë me u mbjatë dëgjimet buxhetore dhe unë këtu kërkoj që degjimet buxhetore të qytetarëve me u marrë parasysh dhe të admintratorëve të fshatit, sepse prej viteve të kalume unë e kam dhe një raport që ka qenë, ku diku 63 ose 64% nuk janë përfshi kërkesat e qytetarëve, edhe ne për çdo seancë si asamblist kemi shpreh kërksat e qytetarëve dhe është mirë që këto kërkesa me u marrë parasysh dhe me u përfshi në këtë kornizë afatmesme buxhetore.

z.Bekim Azizi, kryesuesi: Unë një ju kisha thanë, Korniza Afatmesme Buxhetore, propozimi parë orienton në këto 5 rreshta, janë krejt korniza, sepse ky është propozim i ministrisë, se ne e dimë që vitin e kalum na e ka ndërru mbi 500 mijë euro, na e ka oru më pak pas kornizës së parë buxhetore. Ne mundemi me i diskutu, paga 9 milion e 700 mijë, këto nuk mundemi me i ndryshu, 3 milion e 172 mijë janë mallra shërbime, 300 mijë komunal, subvencione 720 mijë edhe investime kapitale 4 milion e 26 mijë. Këto janë parapa këto 6 rreshta që sot me u disku, këto janë ato që orientohet buxheti, në këto të orientohemi çka mundemi me dhanë ndonjë propozim ne që me dalë

më mirë dhe këto janë me formula që shkojnë dhe nuk e di në atë aspektin sa ka mundësi lëvizja. Pjesa tjetër është më shumë përshkrim.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunes: Këto ne i marrim dhe i shqyrtojmë, i drejtohem ministrisë që nuk na mjaftojnë për subvencione pershembull, por ndodh na e zbritë, janë kriter këto, prandaj ti Majlindë. Unë bëra përpjekje maksimale me të degju por si me të dhanë përgjigje kur ti po delë jashtë krejt aspektit ligjorë, ti fletë thuti që kjo është dëshir e jona dhe ne deshirojm këtë ose këtë me pasë këto jan kontura të cilat i cakton ministria në kuader të saj ne duhet me u sjellë dhe tash ti e potencon shumë asfaltin na keni lodhë me asfalt ti nuk mundesh me thanë se ti harron në këtë seanc unë nuk harroj hiq për atë që tha taulanti na u ke bë si Sali berisha se nuk harroj hiq në seancen tjetër kur ta permendsh thu një rrugë në lubisht pa asfaltu ti delë kontraers me vetëvetem unë këtu e kam atë që nuk mujë me pajtu njeri duhet me pasë një qështje e dyta nuk kam qka të mësoj ty përshkak se je kshilltare dhe këtë qështjen e ligjit mbi vetëqeverisjen lokale dhe punen e kryetarit ti e njef barabart me mu nuk ka kryetar i komunes që nuk e qet prioritet dhe nuk i kerkohet realizmi i planit të vetë është kjo ku dush shko edhe tash e kam ngrit me deputeten e juaj po pse ligji e ka leju në kët formë unë nuk e di shko ndryshoje atje në qender veq në perfundim të mandatit edhe ti ki mu qu me thanë edhe kandidati juaj që ka me dalë për krejt komune edhe kandidati nga PDK ka me tahnë kryetar nuk e ke realizu programin me të cilat i ke fitu votat dhe kan me të marrë dhe tani a e ka tani pe merrë pakuptesin e vetë mbajtja e degjiemve me qytetar unë i kam mbajt ka 25 por jam lodhë më se me të vertet ti ndegjon dhe nuk mundesh me realizu ato a e dinë cilat i realizon ato që janë në kuader të kryetarit, nuk jan nuk mundesh me realizu se nuk kemi asi lluksi ne por megjithatë ashtu është infrastruktura ligjore e rregullume, i keni lodh qytetaret i keni ngulfat nuk ki arsye be me thanë ja kan dhanë mandatin e 3 nuk i ka marrë jashtëtoksor ato vota i ka marrë në Viti andaj është e paqenrushem si me të ndegju unë ty kur ti tregon këtu na mban vajz 15 minut qytetaert kan tahnë diqka tjetër, më të lutem një here e pergjithmonë të shtrohemi në problematik ta shtrojm problematiken ashtu si duhet ehde jam në gjendje me të degju 6 ditë, i keni lodhë qytetaret e keni bë këtë ai njerit mandatin e 3 ja kan dhanë edhe po i thonë hallall të qoftë për punën që po e bënë.

znj.Majlinda Shabani: Fillimisht nënkryetar nime të kuptoj shumë mirë që ndoshta Kornizën Afatmesme Buxhetore ndoshta donë dhe me kalu pa kurnifar diskutimi, po ta kesh me të qartë që, kjo nuk ka me kalu kështu. E dyta, nuk ka nevojë me më tregu se ku duhet unë me u specifiku dhe nuk duhesh me më kthy përgjigje. Tani nënkryetar mjafton me i marrë sugjerimet e mia që i dhashë prej fillimit dhe deri në fund, dhe ki me pa mandej në planifikimin adekuat që bëhet s'ki me pas problem në realizimin nënkryetar. Nuk mundemi me shku me funksionu shabllon. Komuna, 15 fshatra, ngritja e kapaitetit të ujit të pijshëm pa kurnifar analize. Ti po e din që fshati Lubishtë, Smirë, Beguncë, Dobolldeh i kanë specifikat e njëjta dhe problemet e njëjta. Nuk mundesh me ditë këtë, nuk keni bë kurnifar analize, qysh me ju marrë ne seriozisht sot këtu, qysh me ju marrë seriozisht qytetari i Komunës së Vitisë në zgjidhjen e këtyre problemeve, kur ju listimin e investiemve e bëni, 15 fshatra i përfshini në një projekt. Tek çështja e asfaltimit të rrugëve, unë e përmenda, asfaltimi i rrugëve bëhet me cilësinë më të dobët këtu. Është keqpordorimi i taksave nënkryetar, shtroni asfalt, asfalti për 2 vite priset: çka ka me ndodh me atë asfalt? A duhet me u shtru prapë ai asfalt? Prapë duhet me u shtru. Ki plotë politika që mundesh. Sa propozime i kemi përfshi në shtesat për lehona? E ke Drejtorinë e bujqësisë, potencial ka komuna në Drejtorinë e Bujqësisë. Mundeni me përfshi politika që mundeni me i ndihmu fermerëve. Unë shumë mirë i shof. Edhe propozimi që ka qenë prej më herët. kërkesa ime që me u shtru rrugët e arave, d.m.th ato unë i kam bërë kërkesë prej viteve të kalume që u bë. Kryetar, po më vjen mirë që je në seancë, është mirë me ardh më shpesh me na ndëgju prej fillimit diskutimet dhe mos me u perfshi në debat, sepse je kryetar dhe nuk të ka hije kjo qasje e jotja. Është qarkorja e parë dhe kemi kohë, se kur të vjen qarkorja e fundit kemi me ardhë veç me votu dhe unë prap nuk e votoj.

z.Illir Zuka: Realisht kryesues, atë që deshta me thanë e ceke ti, dhe nënkryetari kur e dimë që KAB-i në pjesën e parë deri ta merrë formen e prerë buxheti vjen në kuvend. Unë po themë në emer të grupit të LDK-së ne jemi pro të kaloj kjo pikë e rendit të ditës.

z.Taulant Haxhiu: Deshta edhe unë të lidhen në vija më të trasha te kjo Korniza Afatmesme Buxhetore. Unë po e shofë këtu nuk ka specifikim të projekteve. D.m.th nuk dihet investimet kapitale nuk jan specifiku këto projekte vetëm në vija të trasha janë planifiku investimet. Kanë qenë dashur me u planifiku mjetet për ujësjellës, sepse Vitia e dimë mirë që ka nevojë për ujë. Kemi shpenzu për 11 vjet gati 20 milion për zhavorr e asfalt, kurse për ujë kemi nda për 11 vite vetem 100 mijë euro. Edhe nuk ka përcaktu projekt të sakt, d.m.th nuk dihet çka ka me punu, për ujë unë e di që për 11 vjet janë 100 mijë euro. Nuk kemi parë që keni nda më shumë, unë po foli tek projektet kapitale. Edhe në KAB nuk ka për atë punë ndonjë projekt të sakt, d.m.th nuk dihet çka ka me u punu në 2025, 2026, 2027 ka i qoni mejtet për zhavorr i keni nda gati 2 milion euro vitete e fundit për ujësjellës hiq. Në KAB nuk ka ndonjë

planifikim të detajuar që i plotëson dhe i përgjigjet kërkesave të qytetarëve unë e kisha pas një kërkesë. Kryetar, pasi je këtu me pas debate pak më shumë me qytetarë, jo debate formale që me i dëgju pak kërkesat e tyre dhe në bazë të kërkesave të tyre me i shti në buxhet pak më tepër, se ne për momentin kemi nevojë më shumë për ujë. Unë kam qef që debatet të jenë në kornizen afatmesme, para kornizës të jenë joformale, por të jenë debate që degjohen dhe kërkesat e qytetarëve.

z.Bekim Azizi: Debatete zakonisht pas kornizës së parë që ta kthejnë kornizen e dytë kur na e kthenë fikse fillojnë, d.m.th me ligj debatet që duhen të jenë për me hy në projekte për me ardh në shtator me projekte të definueme.

z.Jakup Demiri: Përshendetje edhe kryetarit. Megjithëse qasja nuk na pelqej kryetar, se kur është duke folë dikush e ka hapsirën e vetë dhe nuk ka të drejtë askush të ja nderpres fjalës ose ta pengoj në punën e tij. Kjo është Korniza Afatmesme Buxhetore e para dhe ne jemi për me shku tutje, ta shohim në debate publike dhe pas debateve publike se sa do të implementohen kërkesat e qytetarëve. Më kujtohet që në fund të dhjetorit pikërisht me 27 dhjetor ka pas një OJQ një debat në shtëpinë e kulturës, megjithatë komuna nuk morri pjesë aty, po aty dulë një statistikë ku diku 97% të kërkesave të qytetarëve nuk janë implemetnu në investimet kapitale. Ishte statistikë. Të pakten nuk kam parë reagim nga komuna që e ka kundërshtu. Ta shohim në vazhdim dhe pas dëgjimeve publike se si do të rrjedh puna e buxhetimit në të ardhmen nga këto që dalin, që fillon nga KAB, nga korniza parë dhe mandej ne jemi këtu dhe do e shohim, po prioritet prap po shihet që nuk është uji i pijshëm, nuk janë disa problematike me të cilat ne duhet të ballafaqohemi apo që ballafaqohet qytetari fillimisht, se një ndër aspektet kryesore të jetës apo nevoja kryesore është uji i pijes është numer 1.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunes: Çështja që e shtroj Taulanti, po më vjen keq që tani nuk është këtu, nuk është për 11 vite 100 mijë, po jan afër 500 mijëve që kemi investu ujë edhe në ujësjellësin e Stublles 125 mijë, edhe në borgjin e 5 fshtrave 100 e diçka mijë dhe në Pozheran 30 mijë, dhe janë shumë të cilët ne kemi investu, por a ka qenë e mjaftueshme është qështje tjetër që duhet ta shtrojmë. Çështja tjetër Majlindë, unë nuk jam msues me të msu, por ligji është mesues që ti duhesh me u sjellë në kuader të saj dhe në rastë se ligji është në kuader të saj mendimi i ytë si kshilltare e kuvendit komunal është veq një individ jo më shumë dhe në këtë drejtim unë të kam thanë se ti nuk ke të drejtë me quajt e keni bënë Vitin kështu se unë e kam thanë në këtë kontest dhe po e themë prap, ata qytetarë të Vitis ja kan besu besimin ti edhe atëhere ke tahën jo kryetar Sokol Haliti por në demokraci perfilllet shumica dhe prandaj atë koncept duhesh me largu nga koka dhe kur të vinë zgjedhjet ki me vrapu dhe ki me thanë për të metat e kryetarit dhe me avansu kandidatit tanë në këtë drejtim në rastë se unë të kam thanë diçka me të msu nuk kam nevoj me të mësu por ligji thotë kështu dhe ky ligj e obligon kryetarin Haliti me u sillë në kaude të saj që i ka fitu votat dhe në kuader të saj ky e ka pas një program me të cilin ka dalë para qytetareve dhe qyteaterevet ja kan besu atë program dhe detyr eti është me permbush atë, sa mundë jashtë asaj me i tejkalu edhe kërkesat e qyteareve do të jetë e mirëseardhur por shko ku dushë në Kosovë edhe te lideri ytë të thotë kështu nuk ka formul tjetër a të pëlqen ty apo jo është qështje e jotja por unë du mu sjell në konfrom dispozitave ligjore që janë në fuqi në Kosov dhe kjo është kështu, Faleminderit.

z.Sokol Haliti, kryetari i komunës: Është e vërtet që reagoval, e pranoj, por është edhe një gjë e vërtet që, edhe si kryetar, edhe si person, edhe si qytetar, si njeri, kurr bisedës konstruktive, as vërejtjes konstruktive nuk i iki, as nuk i reagoj. I reagoj dhe gjithmonë është e vërtet, dhe plus që i iki i reagoj bisedës dhe akuzave destruktive që 100 here e kemi diskutu, edhe sot po ju thamë, dhe sa jemi nuk është me rëndësi a jam në pozitën e kryetarit apo këshilltarit, kryesuesit apo qytetarit, se edhe qytetarët kan të drejtë me ardhë në kuvend, asnjëhere bisedave konstruktive nuk i iki, por apriori kur ta ngris zanin edhe kur të akuzojsh qashtu me atë fjalor, apriori më së pari duhet me kqyrë vetëveten. Bash për këto tema që po i ngritë duhesh me kqyrë vetëveten nën 1. Nën 2, u ngriten tema të cilat kanë të drejtë debate me zhvillu pjesë formale jo formale dhe praktike dhe me i pru në buxhet. Nuk është e vërtet që 98% nuk janë përfshi në investime kapitale, është e kundërta, pa marrë pavarësisht që jemi rival politik në interes të qytetarëve, nuk jemi rival kuvendi. Qeveria komunale duhet me qenë në interes të qytetarëve përtej partive politike, është e kundërta e saj. A ka deficite dhe a ka nevoja më shumë siç e tha Taulanti. Po ka, edhe për debate, se sa më shumë që zhvillojmë debate. Është e vërtet tash po i përgadisim debatet. Edhe me USID-in Amerikan kemi nënshkru kontratën sociale që janë në afat. Debatet e tjera, Zyra e Infromimit është këtu i ka paraqit dhe me kalendar ka përgatit dhe kalendarin. Tash po e bajmë planin e veprimt të seancave buxhetore për buxhet. Ju ftoj të gjithë këshilltarëve me marrë pjesë, pavarësisht a kundërshtohemi këtu, nuk është ajo me rëndësi. Ti me qesh mundesh, por unë po të themë që është e kundërta. Kur të shkojmë në Lubishtë para qytetarëve. Çka po thu ti që po ta themë që këtu prezent ka dhe të tjerë dhe të Lubishtes dhe në qeveri këtu, po të themë që është e kundërta. Dalim para qytetarëve kur të doni, bile dalim bashkarisht si kolegë, nuk është me rëndësi partia para interesit të qytetarëve.

E ti destrektuvisht sillu edhe fjalorin përdore, quaje njerin keqperdrues e çka dush, e tani thuj çka po më thua. Keqpërdorues janë ata që vërtet e bajnë keqperdorimin, që jan me fakte e që dihet, prandaj në këtë kuptim duhet fjalorin me ruajt konstruktiv. Nëse e ruajmë fjalorin konstruktiv, edhe unë po ju garantoj 100% ka me ruajt. Tash unë me hi brenda kryetar komune, tash p.sh.: unë isha me “Hidromoraven” në takim dhe qe 1 orë e 30 minuta për interes të qytetarëve, se nuk isha vetem aty, i kam mbrojt besoj me dijen teme, me përvojen që kam fshat për fshat, tash i njei 19 fshatra tu e mbrojt dhe interesin e rritjes së kapacitetit të ujit për Binç dhe për Kabash, për Dobellde, Skifteraj, problematiken që e kanë atje për Zhiti, për çështjen rrymës pse nuk e kanë lëshu për shkak se e kanë marrë nën menagjim për Budrikë, për Tërpezë, për të gjitha fshatrat: 2 Sllatinat, 2 Sodovinat dhe Tërstenukun, që ka me dalë thirrja dhe për Zhitinë njëjtë me 6 fshatra dhe e kam mbrojt për Beguncë, Verban, Smirë, Goshicë. Edhe për të tjera 4 fshatra i tregova që duhet me nënshkru memorandumin. Unë jam transparent, ju tregoj, ajo delë në ueb-faqe, vetëm lexoni ato janë publike, por kur erdha po të shofë tu bërtit dhe tu akuzu dhe tu i quajt njerëzit keqperdorues, edhe se po kan kulturë politike dhe po të tregon në mënyrë argumentuese që, ligji është mbi ty, mu dhe krejt neve, prandaj është mirë me u rujtë, shembull, se edhe këta janë këshilltar të gjithë, por nuk po akuzojnë. Unë sot pata një takim konsult, po e shofë një kulturë politike që po demostrojnë, p.sh.: dhe nuk po e ninë asnjëhere tu të akuzu se nuk bjenë në atë formë. Unë kam shumë çështje që ne nuk po i ngrisim. Kam pas mendu që unë më heret i kam ngrit kur ka qenë shumë çështje, kam çështje me ngrit për rrugën në Gilan, kam çështje me ngrit për shkollën e Pozheranit, për kyqjen në Gerlicë, për ujin e pijes. Pse u qunë në Kamenicë kaq pare e Vitisë ju lanë 100 mijë euro për ndarjen e re buxhetore? Pse 4 euro Vitisë e Novobërdes 86 euro, 107 euro një komunës tjetër të vogël? Kam çështje tjera me ngrit. Pse çerdhja jonë shkoj në Kamenicë pasi u tenderu dhe tjetra që është tenderu? Dhe po na rrinë atje qe 6 muaj çerdhja 2 katshe që ka me u ndreq afër gjykatës, që vendimin kuvendi komunal e merr këtu. Janë çështje parimore, nuk jan çështje politike, por për interes të qytetarëve, andaj ne këtu bashk krejt këto duhet me i thanë. Pajtohem plotesisht këshilltar, që duhet plotësisht na me ruajt nivelin konstruktiv. Tek ndarja buxhetore. Edhe ju e keni të drejten edhe në seancat buxhetore bashkarisht, pavarsisht prej projeksionit 4-vjeçar që unë e kam paraqit para qytetarëve dhe që unë e mbroj me fanatizëm me realizu. Unë e di që ju e dini në vetëvete, që unë e kam një projeksion si kryetar komune që kam ardh, faktikisht kryetar me votën e qytetarëve, që duhet me realizu. Është obligim i imi instuticional, është politikë, moral njerëzor. Përtej asaj jami hapur se jemi tu punu, kemi kapacitete, kemi donator, po bijmë projekte, po nënshkruaj përditë, kemi mundësi me realizu edhe deficite të tjera që bashkëpunojmë me kuvendin komunal, prandaj prej kryesuesit tek secili këshilltar ju ftojme me bashkpunu dhe deren qelë për ato tema, vetëm fjalori destruktiv. Mos mendoni që unë muj mu pajtu me atë fjalor. Në momentin që ti akuzon në atë formë të ulet, p.sh.: edhe i thuni vetit intelektual të ri dhe perdor asi fjalori, normalisht që e ki kundërpërgjigjen, se është një problem që nuk është në karakterin tim me ta bajt fjalorin destruktiv. Tek e fundit, unë nuk e ndali askënd, por është një gjë tjetër. Ne mundemi me pranu punën që jemi tu e bë, dhe mundemi me i vazhdu deficitet tjera të punëve që kanë nevojë me u bë, ne jemi para projeksionit të ardhshem 2024 – 2025, ne e votojmë, unë ju ftoj të gjithëve me marrë pjesë në atë projeksion. Nganjëhere po thuni ka dojmë ne, jo ka dojmë, por e kam përseritë, edhe njëhere po e përseris, nuk d.m.th mu pajtu ky projeksioni me lloto që i përfshinë të gjitha fshatrat në investime që kamë thanë një here nëse fushen sportive për një here nuk kemi kod, zë buxhetor me ndreq fusha sportive në krejt fshatrat, apo parqet në krejt fshatrat, apo sinjalistikat në krejt fshatrat, apo rrugët e asfaltume, apo rrugët bujqësore në krejt fshatrat, apo urat në krejt fshatrat. Dhe ne përdorim rotacion dhe ata ta mundësojnë për me shpernda buxhetin, mos me qitë më një vend se nuk ka rentabilitet, edhe tek e fundit mund me i përfshi në investime fshatrat ne këtë projeksion të cilin e kanë marrë shumë komuna model prej neve, ka dalë rezultat se i përfshim të gjitha vendbanimet e komunës sonë, kufinjët administrativ i përfshijmë me investime, prandaj në këtë kuptim ju ftoj që me mendu për deficitet e fshatrat bashkë me kryetarët e fshatrave, bashkë me këshilltarët që janë të atij rajoni bisedojmë e kqyrim çka kemi mundësi me bë më tutje, çka po na jetë për vitin e ardhshëm, cilat rrugë të lagjeve po na mbesin, cilat kanale po na mbesin mbyll pa i rivitailzu, cili fshat po mbet pa sinjalistikë, cilat fshatra po mbeten pa lidhje mes vete, cilat shkolla po mbesin pa mjete konkretizuse, pa fusha sportive, cilat po mbesin pa gomë, pa ndriçim, pa tribina, cilat po jesin pa drunjë, pa gjelbrim, cila urë na ka mbetë pa u kry dhe cilat asekte tjera të grupeve të margjinalizume na kan mbetë keq apo pjerrina, ku na kan mbet etj etj. P.sh.: ne kemi hi një kompleksi sportiv tek Drobeshi, që me rrugë që do të lidhen me Pozheran, rruga që lidhë me Sllatinë do të lidhë edhe me Pozheran tek “Ura e Kurteshit” do të delë qëkjo rruga pi grykës së Smirës që u nisë Drobesh, Gërmovë lidhet edhe me Pozheran. Nëse ne e kemi atë kompleks, ne duhet ta bëjmë me parkingje, me ambiente, duhet ta kompletojmë me krejt mjetet konkretizuese, që krejt komunat ta kenë nje kompleks me shtegë të atletikës në rregull. Ta ketë një kompleks ku me dalë, po në anen tjetër kemi fillu projektin që duhet me zhvillu debat, e qesim në poverpoint e

kqyrim krejt. Qeveria komunale e ka pas, por nuk kemi qenë komplet, do ta qesim për shkak edhe pushimeve do ta qesim komplet edhe kuvendi ne ta ketë të parkut të qytetit, i cili do të jetë 1 hektar e 70 ari në mes qyteti, është shumë afer dhe do ta bëjmë një park qytetit për gjeneratat e reja si gjeneratë, qeveri dhe kuvend komunal që do të jetë me të gjitha parametrat: me gjelbrime, lojra, teatra, WC, parkingje, drunjë të mirë, shporta, ulëse, rrugë të zgjerume, do të jetë një park i qytetit që ka me na bë nder të gjithëve pa dallime, atë park p.sh.: ta buxhetojmë bashkë krejt edhe të ja lajm një park qytetit. E kemi sipërfaqen, e kemi lokalizu, e kemi projektin ideor, veç e kemi qu paramasen, paralogarinë ta bëjmë në detaje, që vërtet kjo gjeneratë ta bëjmë një park qytetit dhe kompleksin atje ta përfundojmë deri në vitin e ardhshëm. Shpresoj shumë edhe me palester edhe të jemi vërtet me një nivel tejtër, masandej inkubadori i biznesit kompletohet atje. Ta kqyrim sallen e teatrit ku pe qojmë bashkë me shkollën e muzikës edhe me pjesët e tjera. Këto janë për mua epiqendra e projekcionit të ardhshëm, e që mundemi me i bë bashkë, zhvillojmë debate, nuk ka problem, kur doni organizonu në seancë të kuvendit nënkryetar me kryesuesin, kurdoni me qeverinë bashkë zhvillojmë për çdo temë që na interson me shti në buxhet mrena kapacitetve buxhetore që i kemi, por llogaritne që na nevojitet me nxjerrë dhe fondacine të tjera për me i përbush, se zërat buxhetor edhe investimet kapitale që i kemi me kodë të rregullt nga grandit qeveritar dhe të hyrat komunale momentalisht nuk i kemi të mundshme që me i realizu krejt ambiciet çka i kemi momentalisht, duhet me i nxjerr edhe donacionet tjera, memorandumet tjera me bashkëpunëtoret e tjerë, me Bashkimin European dhe krejt partnerët që i kemi.

znj.Majlinda Shabani: Më lejo me përfundu deri në fund, se nuk dua fare të ju friksohem qasjes së kryeatrit që e patë qysh në fillim të seancës. Fillimisht për me tregu nivelin tand, është mirë që ju këshilltarëve komunal me ju kërku falje për qasjen arrogante, sepse unë nuk kam nevojë për kërkim faljen tuaj dhe nëse ti mendon që mundesh me ma nal fjalën përmes formave të shantazhimit e ke shumë gabim dhe fjalët që i the pas mikrofonit, merre mikrofonin dhe thuaj para mikrofonit, sepse unë pikërisht sot i forcoj bindjet e mia se çfarë kryetari je ti, një kryetar i cili delë në kohë fushate, premton që ka me u zgjidh çështja e ujit të pijshëm dhe i mashtron qytetarët e Vitisë. Për mua është mashtrues, për mua kryetar ti je mashtrues edhe pikë, një nënkryetar i cili përmend ligjet e ai nënkryetar i shkel vetë ligjet. Nuk mundet me më tregu mu për ligje. Më lejoni ta përfudoj fjalën deri në fund, sepse nuk është forma ime e qasjes kështu në këtë mënyrë, sepse kemi pas edhe raste të tjera kur kan ndodh sulme fizike në kuvend komunal, sepse keni tentu me na friksu neve për mos me marrë ne fjalën ama këtë ta garantoj se nuk mundeni me ma ndal fjalën kurrë në kuvend komunal. Formën e shantazhimit që e bere sot në kuvend komunal. Kryetar, nuk mundesh me ma ndal fjalën kurër dhe nëse ti mendon temen që e permende për çështjen subvencioneve, sot dalim haptas dytë flasim dhe deri në fund bajmë ftesa. Qytetarët e Komunes së Vitisë nëse janë tu na ndëgju na bëni ftesa me ardh me bë proopozime, me qenë konstruktiv, me bashkëpunu dhe në moment kur unë e marrë fjalën si këshilltare komunale dhe i shprehi propozimet e mia. A e dinë çfarë qasje keni bë ju sot, a e dinë çfarë arrogance keni bë ju sot. Për mu sot qekjo seancë me këtë qasje tande, për mu je arrogant, për mu je mashtrues tipik, mashtrues.

z.Sokol Haliti, kryetari i komunës: Ti po akuzon drejtpërsëdrejti dhe po na thua arrogant. Pse ne po të thojmë që nuk është ashtu. Sahere të fol destruktivisht unë në kuvned këtu, jemi në debat, unë të themë ashtu.

z.Majlinda Shabani: Çka destruktivisht, thuma një fjalë timen që nuk qëndron. Unë ta argumentoj nëse ajo fjali nuk qëndron unë sot dalë para kuvendin komunal dhe thamë që, përimë nuk qëndron asnjë fjalë që e themë në kuvend komunal nuk qëndron pa argumente.

z.Sokol Haliti, kryetari i komunës: Asnjë fjali e jotja nuk është tu qendru. Për subvencione ti e dinë shumë mirë pse nuk qëndron, nuk qëndron asnjë fjali. Ndesh me ditë punime më të mira që jan tu bë kohët e fundit nuk janë bërë 500 vitet e fundit punime më shumë në Viti ndoshta ajo është tu të djegë nuk jan bërë 500 vitet e fundit dhe 6 mujori më i sukseseshem ka qenë 6 mujori i vitit 2024 dhe unë po ju themë që nuk ka pasë gjasa aktivitetet në dokumentar me i futë sa janë tu zhvillu në Viti në 6 mujorin e parë dhe tjetra sa premisa janë kriju për me punu në 6 mujorin e dytë, Vitia kurr nuk ak qenë në rrugë më të mirë me kaq shumë punë në të gjitha fshatrat pa dallime nëse ndonjë ka mbetë pa projekte shumë frike keni me pa me projektet e veta me hisen e vetë bugjetore që e ka, katerciprisht komuna e Vitis është tu lidhë mes vete mes lajgeve mes fshatrave mes komunave tjera, mee rrugë bujqësore, rurale të asfaltuara, me rrugë që lidhin 4 fshatra, 2 fshatra, me ambient, ekoturizem, tu i perfshi dhe fshatrat ka vini ju.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Më vjen keq këshilltare veq me i thanë një nënkryetarit se ti pe shkel ligjin, ka më duket organe të drejtesis të cilet e konstatojn këtë dhe ky konstatim prej 99 deri në 2024 dmth 25 vite e kan konstatu se Hasan Aliu nuk është shkeles i ligjit asnjehere, nëse në atë barometrën tandë ti që je organ i drejtesis vetë ti e gjykon thuma kur e kam shkelë, se me i thanë dikujt që nënkryetari po thotë respektone ligjin dhe e ka shkel ligjin thuaje kur thuje lirisht.

z.Jakup Demiri: Kryetar kjo punë që ti the ke qenë në takim me “Hidromoravën” 1 orë e 30 minuta, nuk na the se çka është ndermarr nëpër takime me “Hidromoravën”. E për ujin e pijshëm ne ju ngojmë muhabetet që 10 vjet po ujë nuk ka me pi, mandej në fushatën e fundit në emisione televizive mundesh me hy në youtube, thojshë që 24 fshatra kanë ujin e pijshëm. Është i krym uji pijshëm. Ky është problem, unë nuk e di qysh i thanë kësaj, përveç që nuk është e vërtetë nuk po du me quajt më vrazhd. Po keni thanë që 24 fshatra. Po si ka 3 - 4 ditë që e kam ndëgjju në telefon, 24 fshatra në Komunën e Vitisë janë me ujë të pijshëm. Tash del sot thu kam qenë në takim për ujin aty, aty. Çka me i thanë kësaj pune. Për punime dilni kqyrni në teren, kqyrne asfaltin, hala pa pranim teknik e keni të harrnuk, të grrymë. Gjithçka, minihidrocentrali që është maru këtu që e keni shkatrru atë vend total. Ndoshta juve ju duket mirë, po ai është gabimi më i madhë që kemi bë, se kemi shkatrru një vend. Po de po, niveli qendror këtu në kuvend komunal me presion me gjithçka, e për që nuk përfshihesh në punet e të tjerëve, po të tregoj, vjet ishim në Shqipëri. Kuvendi komunal me iniciativën tande i ke pengu komplet asamblistët e juve për mos me ardhë, po ta themë kështu publikisht këtu, se e di çka ka ndodh dhe nuk është mirë me u përzi, se përzihesh edhe në punët e kuvendit komunal, që unë jam pjesë e kuvendit komunal, jam shef i grupit të asamblistëve qetu në Lëvizjen Vetëvendosje. Kry punët anej knej, mos u perzi se nuk është e hjeshme edhe për figurën tane po edhe si kryetar i jemi se je edhe kryetari jem. Më heret vishe thojshë prokuroria. Prokuroria nuk e di më kan është tu marrë prokuroria, është tu marrë me juve me atë me atë. Këto janë që ta dhezin tana muhabetin, ta prishin atmosferen dhe nuk të lënë me punu. Po të themë përzihesh drejtëpërsëdrejti në punimet e kuvendit komunal dhe thu hajde bashkëpunojmë. Ndryshe e ka bashkëpunimi. Dilni kqyrni punimet në teren si i kini. Është pare e qytetarëve nuk është e juaja. E ki madnatin, por e ki madnatin me shfrytëzu. Mos të harrojmë, komuna jonë në mandatin tanë e ka humb edhe grandin e performances, që jan mbi 1 milion euro keq e mirë thuni edhe këtë bre. Ju jeni bile institucionalista, i besoni qështu u potencojshit, thuni që edhe ata e kemi hupë, se kemi shkel ligjin. Do vene nuk është qashtu veq qysh pe thu ti, se edhe qysh e thu nuk ka mundësi me kanë. Hyni, me qenë me ardhë nuk mundet me i bë ashtu si po thu, po thotë bile me prekë pak për toke, nëse thu që Komuna e Vitisë është tu punu mirë dhe është në rregull. Unë mendoj që gabim, se edhe ne takohemi me qytetar edhe ne jemi njerëz, edhe ne dimë diçka, se disa punë nuk është mirë me u kry qështu kur sot e ke lam Vitinë. Nesor i ki mërgimtarët që mezi nuk presin me ardhë, dhe ti e dinë se ki familjar tu, krejt kemi, e dimë që sa kohë e çmushme e tyre përime me jau tarashkat këto punime, se perime ke mujtë me ja nis shumë më heret dhe tash me përfundu sheshin, po je vonu, është gabim, ndesh e pranove ndesh jo. Edhe punimet e tejra. Mos harro, ti po thu veç unë e përmenda. Më heret ta potencoj trotuarin në “Lagjen Alija” në Smirë e ke qe 3 vite e diçka, nisin pa përfundu gjysa e nxansave qaty binë ki vend 80 cm. Duhet fmija, kalojnë aty pari, është i pa përfundnum dorën në zemër, tash nuk e di si e arsyeton, veç tu kisha lut kryje më shpejtë se nuk po du me bë politikë. Kemi dhe shumë çështje tjera, kemi dhe disa rrugë të malit që kemi shtru, i kemi prishë rruget e fshatit edhe ato mu ke arsyeu niher që u dashtë një here ato tani këto. Veç kjo i bjen një formë që është mosplanifikim i mirë, se i bjen sikur prish shpi e maro hajjat. Tani se rrugët e malit nuk është që na duhen ku me ditë sa, se nuk është rrugë që me shku te shpija e me dalë prej shpisë.

z.Sokol Haliti, kryetar i komunes: Unë nuk ju nderhyna në punet e kuvendit, dallimin e kam që unë foli në parim këto pikat e furnizmit të kuvendit i kam bërë unë me qeverin komunale prandaj në momentin që ju kam furnizu me pika të rendit të ditës unë dmth jam përkudrazi jam bashkpunues me letra formalojuridik dhe respektuesi i kuvendit edhe pse e kam mundësi funksionalizmin mbajtejen e kuvendit me rregull dhe me agjent edhe të KPF nuk ju ka mungu asnjherher furnizmi me pika me propozim vendime, nën 2 sa i perket ujit të pijes konktret mundëm me të thanë folim për ujin e smires nga vjenë ti ku jan problematikat pse trafon e ka marrë kompania përshkak se qeveria komunale me projektet që janë bërë deri tani qeveria qendrore është investive bashk me SDS zvicrane nuk është qeveria komunale qeveria komunale ka qenë investive vetem me një memorantum që ka bë ish kryetari para neve që ne e kemi zbatu me kuvendin komunal ajo dihet për goshic,germov, smir, verban, për 5 fshatra, për stubell që kemi bërë 120 e diçka mijë euro që kemi dhanë, qeveria komunale kaq e ka pasë memorandumin e ka kry obligimin e vetë unë bashk me kqyr me ligjë me rend unë e kam kry obligimin temë si qeverisje sa i perket aspektit të investiemve që e kam kry memorandumin që e ka nenshkru ish kryetari, por realopraktikisht nuk egziston mbulushmeria me ujë dhe ne patjeter po duhet me ngrit zanin por duhet me ngrit krejt bashk që verete me qu këtë, dhe kemi marrë obligime tjera tash jemi tu e qitë thirrjen për 6 fshatra tu e perfshi dhe zhitin për me i realizu disa defekte atje që janë bërë, tash na nevojitet me mbulu trafon në aspektet e tjera oporacionale teknike me kemurin shefin e njesis i ndajtem detyrat në prezent të drejtorit të hidromoraves për smir dhe verban se ka problematika, e kemi problematiken e implementimint të ujit në Goshic e ekmi për pak na ka mbetë uji i stublles mu kyqë e kemi problematiken për rrymë 1.8 1800 euro rrymë zhitia për me u kyqë uji por duhet me hy nën menagjim kjo është me

rendesi e kemi rritjen e kapacitetit të ujit të binqes kabashit, kemi problematiken e ujit vetem furnizimin të ujit dobolldehuhet dhe skifteraj që kemi problematiken begunces dhe fshatrave të tjera prandaj një nga një duhet me i zgjidhëneve na ka ra hise kjo qështje nuk është e lehtë, aspekti tjetër i nderhyrjes aspekti i projekteve në teren aspekti i mos kordnimint unë ti nuk të ndali se unë nuk pres prej teje që me mi pranë me më thanë kryetar ti je tu punu shumë dhe je tu bë punë të mirë por për këtë vendos qytetari kshilltar edhe mirë tha nënkryetari që pajtohem plotesisht, ne kemi nevoj për debate parimore projektuese, planifikuese, me u marrë sidomos në këtë temë ku jemi që na nevojitet për të ardhmen dhe aty dallohem cili i jepë kreativiete cili krijon më shumë cili dinë me planifiku më mirë cili jepë propozime konkrete cili i mbron nevojat e qytetareve ne nuk kemi nevoj me u perla kur qyteatri vendos cili e ka pasë me vend cili ka punu më shumë cili ka pru projekte më shumë a ka pas qeveria qendrore në viti a ka pru sokol haliti a kan pru deputetet ndonjë projekt psh, cili ka punu për rrugen e gilanit ku është rruga gilanit, cili ka folë për gerlic shembull qyteatri e vendos, a është e nevojshme rruga skifteraj remnik apo rrugë që lidhë atje me sllatin apo tash me korrant, rruga sllatin ramjan është shtur keq qaty koka keqperdor a , rruga fshati i ri alidemt terpez është shtru keq, ajo tjetra është bërë keq në lubisht psh që është shtru prej pishav ne këtu jemi unë ju kam thanë një here dhe ju themë apert tjetar unë kam vonu projekte a, tjetra grand përformances me grand të performances janë tu u ndreq këto projekte dmth dikush i ka fitu, tash aspekti politik përshkak kontrates kolektive me penalizu një komunë është temë tjetër, unë ju kam thaën dhe ju thamë apert rreth shkolles pozheranit rreth gerlices rreth rruges gilan-kllokot, rreth grandit të performances ne duhet me u kan bashkë ne duhet me i mbrojt këto qendrime bashk se mbrojm interesin e qytetarit përshkak se unë nuk kam faj dhe nuk të ndikoj që kjo qeveria po ajo qeveri psh unë kur ka qenë dhe ish qeveria unë kam pas luftu që rruga autostrada për gilan ti bie ka ramjani të shkon për sllakovc unë fakt kam fillu vetë atë rrugë kemi fillu si komunë dhe këtë rrugen tjetër unë atëhere kam insistu për atë, tash nuk dmth që ne pse është kjo qeveri apo ajo qeveri mos me punu për interes të qytetareve me thanë që këtë projekte psh duhet me realizu bashk, psh ne duhet me lidhë se është një memorandum për rrugen në tanush na nevojitet është një memorandum mes dy qeverive na pse mos me implementu që me qu perpara siq e banem me kumanov pse në kumanov u mundesu etj etj, apo sistemin e ujitjes që kemi nenshkru me ish ministren e cila është anulu e percjellem kryetari gjatë tërë javes nga dikush u akuzu tash ju tash mos e kqyrni si parti politike që atje jeni nëpushtet e këtu në opozitë ne jemi këtu në pushtet atje opozitë ju kqyrne si njerz si kshilltare e si intelektual se kryetari a nuk është dashtë me mbrojtë një projekt sistemin ujitjes për fshatin skifteraj me mbrojtë të cilen e ka nenshkru me ministrin a nuk është projekti memorandum valid i nenshkru prej kryetarit të komunes dhe minsitrit ish ministrin të bujqesis a nuk është dahtë me u implementu aj projekt a është dashtë me u anulu, tash a unë mos me dalë me mbrojtë projektin e skifterajt për sistem të ujitjes i cili i kish shfrytezu kapacitetet hidro ekonomike të lumit letnica me ramje të lirë e kishimd alë në budrik e ka qenë projekt letë i realizushem i shkelqyshem që kish shfrytezu hidroekonomi dhe kish shfrytezu potencial kryesor bunitetin më të mirë të tokes me traditë hambari ipremtaris buqjsore në anamorav bunitetin më të mirë të tokes tek cerneli , unë i kam bërë parakushtet e kam ndreq rrugen skifteraj-mogill i kam ndreq 2 ura që lidhë trekadneshin radivojc-skiftera-mogill e kam ndreq rrugen e cernelit që delë në rrugen prej radivojcit ka të vjenë dhe e kam nënshkru projektin e sistemit të ujitjes për skifteraj dhe qka kan bë këta zotnit kan shku e kan anulu pavarisist si e ka emrin e kan anulu, e tash unë e kam nënshkru me Besjan Mustafen këta e kan anulu tash kryetari është i keq edhe shpifes nuk është përshkak se ka reagu për projektin e sistemit të ujitjes për vend banimin e vetë, mos me pas qenë kryetari në rrjedh duhet me reagu nënkryetari, drejtorja e bujqesis, qeveria komunale, duhet me reagu kryesuesi, kuvendi, krejt grupet parlamentare dhe me thanë që qaj projekt ka qenë valid dhe ai duhet me u kthy mu ndreq se neser po e zamë ndrron qeveria ai projekt realizohet ai projekt ka me u realizu, sistrtemi i ujitjes në skifteraj në shfrytezimit e buniteitt të tokes tradites edhe hidroekonomis të ujit prej Letnices ka me u shfrytezu edhe ka me u rregullu. Singert po ta themë pak para zgjedhjeve unë e kam marrë autoambullanten për Pozheran, pak para zgjedhjeve kshilltar e kam pas nënshkru zonen ekonomike kur ka qenë ministre e tregetis industris Hikemte Bajrami, edhe e di qëndrim tem qfare e kam pasë me vendoseshmeri qe zonen ekonomike a po e eshef e kemi para funksionalizmit se ka shumë investor të interesum komisioni është zgjedhë prej kuvendit komunal edhe ajo është e vertet që është nënshkru pak para zgjedhjev po qka ka lidhje kjo pak para zgjedhjeve është nënshkru edhe rruga e kerbliqit, pak para zgjedhjeve edhe zgjedhjeve eSHBA-s pak para zgjedhjeve bëhen shumë vendime në të gjithë botën përshkak se konkurojn njëra tjetren cila po kryenë punë më shumë.

z.Jakup Demiri: Kryetar, për këto në rregull e këta du me ta potencu, këtë punën e subvencioneve që po i shesin këta që po i marrin subvencionet në bujqësi, ti e thave këtu është vendi ku me i qu, s'ki nevojë me ma thanë mu se ato subvencionet i jep ti, je kryetar komune, je zot shpije e për ata duhesh me qu ku është vendi, se ne këtu kemi folë

do here me emer dhe mbiemer, për shkak se po japin subvencione komuna, jo që nuk ka as tokë e as lopë, as nuk jeton në fshat, jeton në qytetet, në Viti i keni dhanë subvencione. Unë po të themë këtu konkretisht se nuk frigohem prej këtyre far seneve. Ti the që keni marrë subvencione, i keni shitë në një far forme. Majlinden e akuzove tash. Unë pres prej teje me bë një padi penale ndaj persionit i cili i ka shitë, apo me ndermarr diçka, se nuk është që veç të flas. Qekjo është problemi jem me juve që vini këtu akuzoni, akuzoni edhe nuk mbani përgjegjësi. Duhet me mbajt përgjegjësi kur ta thujsh fjalën publikisht. Edhe po lidhesh shumë më projekte rruga Gilanit, kyqja. Lidhem me tonat. Qe shkolla e Pozhernait u dashtë pa ardh Albini hiq me u kanë e kryme, kyqjen në Gerlicë, dokumentet me nenshkrim tanin. Kyqja është e kryme e Gerlicës. A e dinë ku, se ke marrë grand për atë punë, ke marrë pare për atë punë me i zgjeru rrugen e 2 Sodovinave, Sllatinë me u bë kyqja atje ke marrë këtë. Këtë ma ka thanë vetë ish ministri Lutfi Zharku, e kam kry me Vitinë, kryetari i komunës ka hi mandej ka reagu, ka interferu në takim që kam pas te 3 zyrtarët, Bislim Bislimaj, Daut Xhemajli, Samet Idrizi kanë qenë në takim, pasi që më ka bind gati që thotë me qat material që ma ka arsyetu Bislim Bislimaj ka ndërhy kryetari dhe në rregull e kemi kry. Datën e kam harru, por njerëzit janë gjallë. Krejt këto projekte është dashtë me qenë të kryme pa ardh Albini, se i ke pas në dokument çka është ky far zori tash deri të kryhet po ja lajm një mandat. Kryhen edhe këto, po nuk është problemi këtu, problemi është i këtyre projekteve tona të komunës, se gjithë thojshi jo mos u perzini me qeverinë përpara. Tash te qeveria gjuhi ti the rrugët janë mirë krejt. Shko kqyre rrugën e Sllatinës. A e ke pa, më vjen keq, nuk ja du qytetarit atë rrugë ashtu, e kemi pasë më heret një farë projekti rruga e Pozheranit këtu në hymje, ashtu kini pas zotu që kompania është zotu me shtru edhe një here kurr nuk e ka shtru. Qashtu është, e tash unë nuk di çka me thanë.

z.Sokol Haliti, kryetari i komunes: Për dallim prej teje që ke shku me qata edhe qata, për me demantu më së miri qashtu si po e thu nuk është me argumente. Unë flas që bindesh edhe ti vetë edhe pse e dinë, unë nuk kam shku me ata dhe ata po unë kur kam shku në takime për kyqje në gerlic unë kam shku me krejt partit politike me shefat e grupeve parlamentare edhe shefi i grupit të vv ka qenë aty besa edhe kryetari i AAK ka qenë aty, dmth kjo i bie që unë i ke krejt deshmitaret e partis politike shefat e grupeve që unë kam qenë nivelin më të lartë e kam mbrojt kyqjen e gerlices përpara kryetarit, edhe pse kam qenë i zoti me nxjerr rrugen për rivitalizimin e saj prej sodovines deri në dardani tani është temë tjetër ato debate janë të njoftura, e verteta e gerlices është këtu që ja kam thanë dhe kryeministrit kurti unë nuk e kam ditë kush vjenë se nuk është ajo me rendesi kryeministri është kryeminister edhe hoti kur ka qenë unë kam qenë kritik dhe me kembgulje që po thu ti rrugen për kllokot gilani kam kqyr me nxjerr po ka qenë me 2 kursi me trotuare me ndriqim prej kllokotit, radiovojit, budrikes, parteshit, livoqit e deri atje në hymje, me rigolla për ujra sipërfaqore me të gjitha ashtu ka qenë projekti, është e njour atë që kam thanë unë se e di sakt me insisitimin temë kur ka qenë kryeminister Mustafa ka hi në renddite qështja e gerlices kjo është e njohur është dokumenti dhe ka formu kshill nderministror me marrë vendim për gerlic, me kshill nderministror ka qenë edhe lutfi zharku ka qenë dhe hikmete bajrami dhe kshilli nderministror ka marrë vendim me bë kyqjen e gerlices kur ka ardh kryeminister z.haradinaj ka dalë tenderi për kyqjen sipas vendimit të qeveris mustafa ka dalë tenderi në qeverin haradinaj edhe tenderi ka perfshi edhe kyqjen në babush edhe mbikalimin në elez han edhe kyqjen në geric dhe unë kam kërku që meu nda kyqja e gerlices prej babushit se vënë shpronisime edhe rej mbi mbi kalimet atje por me u lanë 8 deri 12 milion euroshi që kyqja e gerlices me fytrat për Viti mu zgjeru dhe në atë kohë kemi mendu që rruga për kllokot gilani dhe zgjerimi i fytit prej gerlices deri në viti na mbetke vetem rruga kllokot sejev ku i rake bondstilli ka qenë një 8 milionsh i cili ka pas tepru prej atij fondi dhe ne kemi dashtë me insistu me bë, jan ndrru qeverit dhe oër shkak të qmimit të shtrejt vendimi është marrë me aprovu është bërë qmimi i lirë qe ku jemi ky është realiteti 100% prandaj unë qendroj prapa kerksave qendrimeve të mia që jan kanë institucionle përshkak se unë i kam perfaqesu interesat e kuvendit komunanl kemi pasë vendime që i kemi marrë këtu të gjithë bashk po nuk i kam perfaqsu vetë i kemi perfaqesu me perfaqesuesit e të gjitha partive politike atje në prishtin.

z.Taulant Haxhiu: Kryetar, fole pak për ujë. Deshta me u ndërlihdh pasi jemi te uji. Respekt për ato fshatra që i diskutove, që je tu i dashtë me bë për shtimin e kapacitetit të ujit, po ti e dinë që vendanimi më i madhë në Komunën e Vitisë është qyteti i Vitisë, më së shumti banorë ka Vitia, ka problematikat më të mëdha me ujë. Veç po du me ditë çka kemi bë për përmisimin për shtimin e kapacitetit të ujit në Viti, kur të bjenë shi, kur të ka stuhi 8 deri 10 orë mbetë pa ujë, qytetarët e Vitisë deri në 3 ditë mbesin pa ujë, ka ujë të trubëll. Filtrimin e ujit a diçk tjetër të ngjashme me filtru ujin nuk kena bë kurgja hiq. Unë e di, dhe ti e dinë që, më së shumti që kemi nevojë për ujë nuk kemi për asfalt. Qyteti i Vitisë, vendbanimi më i madhë nuk ka ujë. Unë nuk e di qe 12 vjet gati si kryetar komune çka ke bë për përmirësimin e shtimit të kapacitetit të ujit. Besoj që për ujë me folë duhet me folë se është i rëndësishëm. Është ajo fjala e urtë >>pa ujë nuk ka jetë<<. Kështu që, nuk kemi nevojë me folë. Tema tjera neve na duhet uji. Unë po foli në emër të qytetarëve të Komunës së Vitisë, se jam nga ky lokacion, vendbanimi, qyteti më i madhë në Viti nuk

e ke diskut asnjëhere për ujë. Unë jam në mandatin e dytë, asnjëhere nuk të kam ndëgjju me fol për ujë. Është mirë se pak po të shohim në seanca, është mirë me na informu për ujë, çka do të bëjë Viti për shtimin e kapaciteteve të ujit. Nuk kemi nevojë për asfalt, kemi nevojë për ujë.

z.Sokol Haliti, kryetari i komunes: Këshilltar, pse s'po mujm me folë për tema kryesore për interes të qytetarëve. Dëgjo, është e vërtetë kanihere përshkak se po zhvillohen tema dhe debate kaniher të pa nevojshme dhe ne po bëhemi pjesë patjetër, edhe po të akuzon drejtë për drejtë edhe po thotë pse po ma jepë përgjigjjen kështu, ne normalisht që kemi me dhanë atë përgjigje se nuk është qashtu qysh po thot. Tek uji i pijes për në Viti ne kemi realizu lagje lagje ti e dinë gypin e azbezit që kemi ndrru etj ti e dinë se te Ylvi Demiri e kemi qu trazen e re që e rrokë prej call me rey e krejt atje kqa shku prej qardakut e dinë që rrugen ka kisha ordodokse te stacioni autobuseve e kemi kry tashkemi me vazhdu ehd epjesen tjere ndersa të hanen fillon projekti i shtrimi të ujesjellsit për lagjen ka zona ekonomike më heret që e quajshmi ka mediterani tek bizneset ku jan 400-500 puntor faktikisht fillon të hanen, a e ke pa trotuarin që kemi nalë përshkak të procedurave po të hanen fillon implemtenimi, unë qatë her provova me të tregu se ne kemi nenshku projekti me banken boterore 3 milion e 100 mi për rritjen e kapacitetit të ujit, na u ka nevojit shpronsimi i një parceles i cili ka qenë me perkatsi kroate në kroaci tash na ka ndihmu e kemi indetifiku se nuk kemi të drejtë ligjore pa bashkpunimin edhe miratimin, tash do të shkojm shumë shpejt në realizmin e kapacitetit për 100 litra në sekond, te turbullirat ke të drejtë ne jemi tu punu me një fondacion për parafiltrim natyral të vetmen shanc e kmei në menyr që kur të kemi reshje të mëdha mos të kemi trubullina dhe në dalje të ujit në qytet, është e vërtetë që shtimi i fshatrave në ujesjelles qendror neve na krijon nevojen e rritjes së kapacitetit të ujit, po tash projekti flovs i bankes botrore me hidromoraven nuk po na lejon ne me forcu kapacitete rritse naj preseke të ujit siq e themi 20 litra në sekond që kemi pasë mundesi me bë, ne nese shikoni zerin bugetore ne kemi pas mjetet e ndame dhe vitin e kalum edhe këtë vitë e kemi lanë si kodë që nese na lejohet ne me shtu 20 litra në sekond përshkak se prurje kemi veq me realizu se tash nëse shtohet stublla na menjere na merrë 20 litra në sekond apo 15 me parametra profesional e dinë ingjinerat më mirë kështu që në këtë kuptim nuk jemi tu nejt duar kryq jemi tu punu, të ahenn fillon ajo pjesa e lagjeve prej ambullates deri te mediterani.

z.Nexhat Halili: Kryetar, deklarove që këtë 6-mujor janë investimet më të mëdha në Komunën e Vitisë. As nuk e pohoj as nuk e mohoj. Unë e kam një pyetje, kur do të përfundoj trotuari i cili lidhë Sllatinën, Tërstenikun dhe Sodovinën e Muhagjerëve. Gati se u bë një kohë e gjatë diku 2 vite ende është në fazën fillestare. Tash po du me u nderlidhë tek KAB-i. Një pyetje kam, përmirësimi dhe rigjinerimi i infrastrukturës rrugore. A parashihet rregullimi i samaforave të cilët nuk janë tu funksionu te rruga e Pozheranit? Kam dhe për drejtoreshën e ekonomisë. Disa gabime jan në llogaritje. Nuk besoj që është bërë gabim i qëllimshëm, po t'i potencoj. Te tabela nr.2, kur ke bë llogaritjen nuk dalin, dalin vlerat 60 milion e më tepër që janë vlera enorme. Tek tabela nr.1, te viti 2024 në tabelen e parë i ki te grandet për shërbimet rezidenciale 155 mijë, te tabela tjetër i ke 160 mijë: cila është e sakt.

z.Sokol Haliti, kryetari i komunes: Sa i përket trotuarit, edhe pasi je njohës i lamisë e kam më lehtë me diskutu me argumente. Është projekt 2-vjeçar, jo 3-vjeçar, vazhdon kryhet sivjet pjesa parë, pjesa 2-të është procedurë, kryhet edhe ngjitet, është procedurë. Tek trotuarët, për sivjet projekcioni 2023-2024 edhe vazhdon kryhet, ndërsa 2 rrugët në Trestenik fillojn këtë javë. "Ali Muhaxheri" besa me sa di edhe ka fillu, trotuari e ka dinamiken e vetë.

z.Nexhat Halili: Vetëm kontaktoje mbikëqyrësin dhe kompaninë, që në t'i fillojnë aktivitetin, ne ta kryen punën.

z.Sokol Haliti, Kryetari i komunes: Për çdo ditë i kontaktoj, për çdo ditë 4 -5 orë në sallë mbajmë takime në detaje. Ndash me ditë, që 1javë, 10 ditë, 50 here është diskutu çështja e trotuareve Sllatinë-Trestenik. Ka me u zhvillu me dinamikë, ta keni të kjart, ta kam pas spjegju një here edhe një here po ta themë, ne kur i kemi planifku trotuarët nuk kemi mujtë me i bë pjesë pjesë ka 100 metra. Ne kemi ditë që buxhetin nuk e kemi për aq kilometra. P.sh.: Sodovinë - Sodovinë me lidhë Sllatinë - Trestenik etj. P.sh.: si e kemi nisë Fshatin e Ri, Devajë - Radivojc, Goshicën, Germovën etj. Ne kemi qenë të vetëdijshëm për këtë punë, por nuk kemi pas mundësi me planifku, se trotuari nuk planifikohet ka 50 -100 metra, se nuk jan rrugë lagjore. Prandaj, ne kemi planifku në tërësi e kemi lanë afatë gjatësinë, dinamikën më të gjatë, por kemi mi kry, me i përfundu. P.sh.: trotuari Sodovinë - Sodovinë është afër përfundimit. Njëjtë e kemi pas situatën, njëjtë kemi me pas aty. Ose Goshica tash është afër përfundimit. Kemi planifiku edhe finisherin, pjesen tjetër që ka mbetë, që kemi shty prej asfaltit edhe ajo do të kryhet. Normalisht që kemi pas në implementim e sipër kritika etj, po kur të rregullohen në fund mirë të tjerat harrohen. Kështu që unë ju garantoj që ajo ka me u rregullu në mënyrën më të mirë dhe keni me pa vetë, sikur që ju thashë për ujë Taulantit që fillon të hanën. Edhe ajo do të fillon, do ta shikojmë bashkë.

z.Nexhat Halili: Veç po të potencoj se këtu i keni nda gati se në dy faza. Fazën e parë në Sllatinë e keni nderpre. Tash e keni inicu procedurën tjetër për fazën tjetër të trotuarit, mirëpo kjo faza e parë me të vërtetë është vonu. Mundësisht kontakto me ta ne të fillon puna, në të përfundon puna.

z.Sokol Haliti, kryetari i komunës: Pjesët e infrastruktures në planifikim dhe në implementim janë si pjesët e pijeimit të ares së rrokë plantimi i parë, e rrokë i dyti barin, se nuk mundesh me kry krejt menihere, por edhe ky planifikimi i dytë është 2023-2024, ky planifikim çka është tu implementu është 2022-2023. Tash kjo ka vazhdimësi në punë dhe nuk mbetet pa u kry, se ne edhe kur ta qojmë te shkolla trotuarin në Trestenik ka me pas dhe nevoja tjera.

z.Nexhat Halili: Veç nja po ta potencoj, faza e parë ka me të përfundu këtë vit kontrata.

z.Sokol Haliti, kryetari i komunës: Po, po rregullohet.

znj.Milihate Ajeti, drejtoresha: Gabim teknik, tash po kqyrim e rregullojmë.

z.Jakup Demiri: Kryetar, e pata pak më heret se e thashë, por po e themë prapë, do të thotë edhe këtë vit Zyra Kombëtare e Auditorit e qet Vitinë në raport të kualifikuar, d.m.th që nuk është në rregull.

z.Sokol Haliti, kryetari i komunës: Vitia te auditimi e ka performncen më të mirën në Kosovë, ka më së pakti rekomandime në nivel vendi. Ka ekonomista këtu që e dinë dhe e shohin raportin. I vetmi rekomandim i cili e penalizon Vitinë është kontrata kolektive. Kontrata kolektive kurr kryetari i komunes së Vitisë, Sokol Haliti nuk e pranon që është përgjegjësi dhe është shkelje ligjit me 2 kamt. Penalizmi i një komune me një vendim që nuk e ka nënshkru komuna por e ka nënshkru niveli qendror dhe mos aprovimi i saj apo mos sigurimi i fondit dika, mbaje mend se ka organe të pavarura, ka me penalizu herdo kurdo dhe unë po ju themë kështu, nëse ka Gjykatë Kushtetuse, nëse ka nivele të larta të drejtësisë, këtë vendim që nuk e aprovojnë apo nuk e sigurojnë fondin për komuna, ja prishin strukturen buxhetore edhe i penalizojnë, ja ndalin grandet. Dikush ka me penalizu. Edhe një here po ju thamë, më së pakti rekomandime në nivel vendi kemi, jemi shumë mirë në rekomandime. Kontrata kolektive është ajo e cila edhe komunën tonë, qato 2-3 komuna që nuk kanë tri ato shiko çka kanë bënë unë atë formë nuk e aplikoj se nuk kam nevoj unë me shku me bënë marrveshje me gjykatën dhe me pranë një vendim në memorandum të cilin nuk e kam nënshkru unë por e ka nënshkru niveli qendror.

z.Bekim Azizi, kryesuesi; Unë veç një po themë që, më vjen keq që në këtë pikë nuk kemi diskutu për këtë pikë kurgja, nuk kemi diskutu për KAB. E qes në votim që të miratohet KAB-i. Pra, me 19 vota pro, 1 kundër, 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Pra, shkojmë në pauzë. Në ora 2 shihemi në Seancë.

z.Bekim Azizi, kryesuesi: Po fillojmë me pjesën e dytë të seancës. Faleminderit që jeni këtu. Është bërë pak traditë që mas ditë po na mungojnë një numër. Pe dinë që nuk po ja ndalim meditetjen. Vazhdojmë me punën e Kuvendit.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2023 në vitin 2024

znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Në infrastrukturë publike janë nda 170 mijë euro; shërbimet e shëndetësisë primare 80 mijë euro; arsimit fillorë 30 mijë euro dhe arsimit i mesëm 30 mijë euro. Në kategorinë ekonomike, subvencione dhe transfere, shuma 7572.43 euro. Zyra e Kryetarit në kategorinë ekonomike, shpenzime kapitale, prej 3 mijë e 700 nën programin e buxhetimit 17533, shuma prej 3700 në projektin blerja e foto aparatit digjital profesional. D.m.th ky është një projekt i ri që duhet me shti në këtë.

z.Musli Neziri: Drejtoreshë, gjatë leximit të këtyre shumave realisht ne kemi pas materialin te pjesa e blerjes së foto aparatit digjital profesional, shuma është 3700 euro. Unë nuk e di çfarë aparati është ai, a çka jeni tu dashtë me bënë. A keni qelë ndonjë studio për foto apo gjirim të dasmave? Nuk dua të marrë pjesë këtu, nuk votoj, jam kundër tij, d.m.th përderisa ne kemi kërkesa nëpër shkollë që nuk përkrahemi asnjë cent nëpër dita të shkollave, dhe të vjen këtu 3700 euro për një aparat, qytetarët e Komunës së Vitisë duhet ta dinë se ka po shkon buxheti i kësaj qeverie. D.m.th 3700 euro për një aparat digjital me dalë në foto, ndërsa për ditët e shkollave kur po kemi kërkesa asnjë cent përkrahje nuk po e kemi, 0 përkrahje dhe këtë e themë me përgjegjësi të plotë, sepse kemi pas ditën e shkollës me 3 maj “Jonuz Zejnullahu”, asnjë përkrahje nuk kemi marrë. Të gjitha projektet që janë punu aty janë punu me forcat tona prej mësimdhënësve që kanë pagu me pare të veta edhe pse janë zotë që ka mjete, për këtë pjesë prap nuk është dalë. Prandaj unë jam kundër, votoj kundër.

z.Jakup Demiri: Drejtoreshë, po më intereson pse këto mjete nuk janë bart deri në mars? Dhe pyetja dytë, dhe këtu po shkruan që, përveç bartjes ka edhe obligime të pakryera. Këto obligime a janë pas 24? Po du përgjigje të sinqert, se ka me të edhe kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, për shkak se qeto kemi të një pyetje. Na u ka pas përgjigje shefi i Zyrës së Prokurimit, na ka pas thanë që jemi 0 obligime ndaj operatorëve, e ne kishim takime me operator të ndryshëm që kishin punu në teren nëpër Komunë të Vitisë të cilët nuk ishin kompenzuar për punën e kryer, e tash a ka edhe ndonjë fakturë të papaguar aty dhe kjo puna e foto aparatit u lidh kolegu para meje. Nuk e di që është një shumë prej 3700, nuk është që kuptojmë shumë nga teknologjia siç është në pyetje, por po më duket shumë e madhe 3700 një foto aparat, edhe ashtu e di që ka fotoaparat, po me këta telefona celular tash edhe kryhen këto obligime, tu pas parasysh që kemi shumë nevoja të tjera.

z.Illir Zuka: Realisht edhe Jakupi e ceku për shkak që veç është me vonesë, përndryshe në çdo vit e kemi të bartjen prej vitit të mëhershëm në vitin që jemi, dhe te kjo dashta me u nderlidh, nuk e di sa muj me ndihmu, po besoj që kjo është e caktuar si shumë. Nuk d.m.th që kushton aparati 3700, se na e dimë edhe pjesët tjera. Shembull po du mu lidhë, kur është bërë tenderimi për zerim, e dinë drejtori i kultures, atje shembull është 6 mijë euro, hinë dikush e fiton me 4 mijë euro. D.m.th kjo është veç vlerë e parapame, ndoshta me 500 - 700 euro, po është veç shumë që duhet me qenë aty, përndryshe unë nuk e di që ka aparat me atë shumë, se familja ime merret me atë punë dhe nuk besoj që ka aparat 3700 euro. Po besoj që drejtjoesha na spjeron më hollësisht.

z.Nexhat Halili: Kam pyetje rreth bartjes së të hyrave prej vitit 2023 në vitin 2024. Këto të hyra janë të hyra të cilat janë të rritura 321 mijë e 272 euro. Pse nuk barten edhe pjesët tjera të të hyrave vetanake, apo barten më vonë.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Çështja e fotoapararit mos ta bëjmë problematik. Është kërkesë e Zyrës së Informimit. Krejt jeni dëshmitar që ne kemi pas aparat, kemi, po tash koha i amortizon dhe atë duhet me ndërru, dhe kjo është një shumë avans. Sa do të jetë aparati, a do të jetë 400 apo 500, a 1 mijë, a e kalon shumë 3700 nuk e di, se nuk jam ekspert i asaj, por megjithatë duhet ta kuptojmë që është avans. E dyta, për shumën e mjeteve vetanake ju e dini mbylljen e vitit fiskal dhe masanej deri në natën e vitit të ri ka që vijnë e paguajnë tatimin në pronë, dhe kjo është shuma të cilën ki këtu. Nuk është rritje kjo, është e parapame, por megjithatë janë mjete të cilat barten. Rregullisht bëhet kjo punë.

z.Nexhat Halili: Tash po e pyes edhe Beratin edhe drejtoreshën sa janë të hyrat të cilat barten prej 2023 në 2024. Këtë e ke në fond të vitit 2023. Kur të bëhen pasqyrat në janar i ke në 2 pozicione. Një pozicion i ki të të hyrat të cilat janë rritur dhe një pozicion i ki të hyrat të cilat barten prej 2023 në 2024, e unë po pyes tash: i ke pozicionin e të hyrave të rritura me të cilën po e bartni sot? E pozicionin tjetër kur do ta bartni?

z.Bekim Azizi, kryesuesi: Nexhati mirë e ka! Ne zakonisht i kemi bartë 2 pika, kemi pas çdo herë një pjesë barten të hyrat e mbetura, d.m.th që janë të planifikime të pashpenzume dhe një pjesë bartet rritja çka është mbledh më shumti se sa është parapa. D.m.th që është rritje, d.m.th çdo here me 2 vendime kemi shku, sivjet është veç një vendim. Unë kam diskutu me Beratin, besoj që ky e jep sqarimin më mirë.

z.Berat Zuka, zyrtar për financa: Përshtetja për të gjithë! Po e ndihmojmë drejtoreshën lidhur me problemin e bartjes së mjeteve. Muajin nëntor kemi të rritje të buxhetit prej 60 mijë eurove në fund të vitit me 31 dhjetor edhe 321 mijë e 272.43 cent kemi rritje të buxhetit nga i planifikum. Çka do të thotë 60 mijë që i kemi të tejkallim të buxhetit edhe 321 mijë bajnë 361mi e 272.43. Këtu përfshihen edhe të hyrat e paplanifikuara. Në këtë rritje të hyrat indirekte të nivelit qendor që janë të hyrat e gjobave, gjykatave, polici, ekonomisë, pyjeve. Tjera, ne kur e kemi të raportin financiar e keni këtë shumë që është tejkallu dhe në raportin financiar që e kemi dërgu në Ministrinë e Financave. Ministria e Financave deri në fillim të qershorit me departamentin e buxhetit nuk kanë mund me harmonizu, sepse kanë të një gabim. Ata kanë dashtë 381 mijë euro me naj kalkuku, mirëpo në fund prapë barazimi. Unë ju kam dhanë sugjerimet që kemi pas vendimin e rritjes së buxhetit dhe që na u kanë aloku si në fillim të qershorit na u ka dhanë instruksioni për bartjen e mjeteve nëpër kategori të cilat komuna ka nevojë. Këtu janë të hyrat edhe direkte edhe indirekte.

z.Jakup Demiri: Veç edhe një sen po du me sqaru. Të hyrat e planifikuara edhe destinohen, të rriturat që janë jashtë planifikimit nuk mundesh tash me i bartë te dyat me një lini, për shkak se ato kanë qenë të planifikuara diku dhe këto kanë qenë të paplanifikuara. Edhe për këtë një sqarim me na dhanë ish kanë mirë, se kur po i lexoj pasqyrat financiare në fund të vitit nuk po na delë qeshtu.

z.Berat Zuka, zyrтар i financave: Të hyrat e planifkuara janë alokuar me centi në ato programe dhe në ato kategori ekonomike, unë nuk mendoj që ka asnjë faktur nuk gjindet në departamentin tonë obligime të pa pagume nga viti i kalum ato jemi të obligim me i pagu me bugjetin e vitit 2024.

z.Jakup Demiri: Po bjen ndesh me ato çka thuni. Nuk është ndonjë telash, por po bjen në kundër thënie me praktiken për shkak se ne po lexojmë që ka mbetje të papagume.

z.Berat Zuka, zyrтар i financave: Mbetje ka pas, por ne kemi kry ato obligime me buxhetin e vitit 2024, sepse ato nëse nuk i pagujnë ata e kanë përmbaruesin privat. Ju e dini si na ndëshkon. Ne i kemi pagu me buxhetin e vitit 2024.

z.Bekim Azizi, kryesuesi: Unë një e di që çdo here të hyrat vetanake i kemi bartë të hyrat që kanë qenë të planifikume edhe rritje me 2 vendime, zakonisht i kemi bartë në muajin mars dhe ne e dimë që vitin e kalum kemi pas shumë probleme disa që u deshke me i marrë vitete e më hereshme, por unë edhe në mars jam konsultu me Beratin. Me sa e di ka ndryshim edhe në ligj diçka, se ato barten automatikisht, ato që kanë mbetë alokohen në kodet që kanë qenë, që nuk mundemi me u ndrru kodet, ndërsa kjo është veç te rritja e buxhetit që bartet për sivjet.

z.Berat Zuka, zyrтар i financave: Kryesues, të gjitha veprimet që po i marrim ne atje nuk po kemi kohë pjesa e mbetur e të hyrave vetanke të cilat kanë mbetë deri me 31 dhjetor që kanë të alokume kan qenë të zotume qka nuk jan shpenzu automatikisht ministria e financave në muajin prill i ka bartë në të gjitha ato programe kreysuesit i kam tregu edhe me 0.33 cent i ka bartë automatikisht i vetmi vitë është prej 10 viteve të fundit që për herë të parë minsitria e financave e ka apliku kjo sot që po e debatojm kjo është rritje e të hyrave vetanake nga plani që është perzantu në kuvend.

z.Bekim Azizi, kryesuesi: Shumë e kjart, pjesa që ka qenë që kemi bartë me vendim prej sivjetit ka fillu të aplikohet automatikisht, ministria i ka bart, kemi bisedu me Beratin, ka kode që kanë mbetë 33 cent dhe ato i ka bart. Tash vetëm rritja e buxhetit çka është mbledh bartet.

z.Nexhat Halili: Pasqyrat financiare të cilat janë dorëzu në raport në shkurt të 2024, por deri me 31.12.2023 i ke të hyra të pa shpenzuara të vitit 2023 që barten në 2024 i ke 132 mijë e 997 plus i ke të hyrat nga rritja e buxhetit nga të hyrat vetanke 321 mijë e 272.43 që në realitet janë 454 270 ju keni pru tash vetem bartjen e321mi e 272 euro.

z.Bekim Azizi, kryesuesi: Shumë të kjart jemi, ky e ka pru bartjen, rritjen, pjesën tjetër e ka bartë ministria automatikisht sivjet. Prej sivjetit ka fillu se vitet tjera i kemi bartë ne me vendim, tash i ka bart kodet si kanë qenë të alokume.

z.Berat Zuka, zyrтар financiar: Ligjet e buxhetit, pika 7 thotë: të hyrat vetanke të realizuara gjatë vitit 2023 dhe të rigjistruar në SMFK që i tejkalojnë shumat e të hyrat të ndara në tabelen 4.1”. Kjo shuma është 321 mijë janë gjetë, por nuk jan të planifkuara, por jemi në tejkalim atë pjesë. Ne po e bartim atë pjesën tjetër e ka bart ministria për herë të parë që 10 vitet e fundit, deri sa nuk vjen instruksioni nga departamenti i buxhetit nuk kemi të drejtë me bart, e ka bart Gilani, Ferizaji ju ka kthy vendim jo i ligjshëm i kuvendit komunal.

z.Nexhat Halili: Berat, është hera e parë që barten këto vitin e kalume nuk ka qenë njëjtë.

z.Berat Zuka, zyrтар financiare: Po, është hera e parë për 10 vitet e kaluara edhe vitin e kalumë me kuvend jan bartë dhe kemi pasë të drejt me ja ndrru destinimin e kategorive dhe nenprogrameve në bazë të nevojave tona kemi pasë të drejt.

z.Bekim Azizi, kryesuesi: Për këtë pjesë u diskutu 3700 euroshi që është planifku një projekt i ri te këta që e diskutoj Muslia unë edi që zyra e infromimit ka nevoj për mjete ndoshta ka qenë mirë me lanë dhe për mjete tjera.

z.Milihate Ajeti, Drejtoresha: Paramasat shkojn normal qështu me këtë qmim procedurat e prokurimit.

z.Jakup Demiri: Rregulli më i mirë është kur i ke 3 profaktura dhe e dinë afërsish. D.m.th kur i ke 3 profaktura për një pajisje apo makineri, atëhere e ke edhe një çmim pak më real, por si shumë tingllon shumë 3700 euro aparatin. Komuna e Vitisë mundet me thanë njerëz, se gjithë ekskluziviteti, lajmi parë nuk e mund asgjë, as i dyti, as i treti, as arsyetimi. Po në rregull, kemi mujtë me emru pak më ndryshe jo për një aparat po për çështje teknike digjitale, ajo mua më bëri përshtymje një foto aparat 3700 euro mu dokë shumë.

z.Bekim Azizi, kryesues: Pasi që nuk ka për debat e qes në votim. Pra, me shumicë të votave pro, 1 kundër, 0 abstenim miratohet ky vendim.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin-ndryshim të vendimit Nr. 01-110/05-670, të datës 30.04.2024 për aprovimin për bartjen e mjeteve nga një projektë në projektet tjera në shumë prej (148.376,16) Euro

z.Bekim Azizi, kryesuesi: Këtë propozim vendim unë e kam kërku për me sjellë në kuvend sepse gjatë bartjes së mjeteve që kemi bartë vendimi na u është kthi i ligjshem mirpo është bërë një gabim teknik, gabimi teknik është bërë tek kodi kur janë bartë mejtet 5387 është dashtë me qenë 53845 kan kërku me e-mail drejtoria me bë përmismin se është bërë gabim teknik ata ja kanë dhanë me një formë një mundesi po ka qenë prap jo lgjyroe atëhere unë kam thanë me bë plotesim ndryshim, është gabim teknik mirpo gabimi teknik me marrë dikush me permisu kodin prej 7 në 5 dmth opjesen e fundit nuk kan guxu unë kam propozu që është më mirë me ardhë në kuvend për plotesim ndryshim.

z.Jakup Demiri: Për gabime teknike nuk e di pse duhet me ardh në kuvend komunal, se si votim si kuvend komunal ka kalu, gabimet teknike i rregullon administrata. Nuk është më obligim i joni. Ti veç rregulloje që kthehet ajo, unë jap përgjegjësi. Një seanë për gabimet teknike nuk kthehet në kuvend komunal kryesues, gabimet teknike i rregullon administrata, votimi është i kryem, njihet.

z.Bekim Azizi, kryesuesi: Unë nuk kam amrrë përgjegjsi pasi ka shku në ministri me marrë me ndryshu. Unë kodin dhe këta të drejtoris nuk kan marrë pergjegjsi se është përgjegjsi personale një e-mail e kan dergu por në fund ju kan thanë që është rekomandu që me dalë në propozim vendim dhe këta i kan rekomandu apet me ardhë sikur i kam propozu unë drejtoreshes që është më mirë me ardh në kuvend që mos me pas pergjegjsi një individ,

znj.Milihate Ajeti, drejtoresha: Edhe pse na e kan dergu e-mailin për me kalu ata prap se prap e kan kërku një plotesim ndryshim.

z.Bekim Azizi, kryesuesi: A jeni që të miratohet ky plotesim ndryshim? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e Vendimit me Nr.01-060/01-116, të datës 01.02.2024 për këmbimin e pronës së palujtëshme komunale me pronat e palujtshme në pronësi të pronarëve Kadri (Bislim) Emërllahu dhe Agron (Ahmet) Ahmeti

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunes: Kryesues, unë pa dashtë me u fy, kriteret e juaja sot në grupin e këshilltarëve kam kërku me qenë drejtoresha por kryetari pa e llogarit që ka kuvendin e paska leshu në pushim vjetor kam kerku Hidajetin por tash më tregoj që paska njerez shumë atje te kadastri dhe këtë propozim vendim ju e keni pasë edhe një here megjitahtë ata e kan kthi në rishqyrtim me disa permisime të cilët nuk jam leshu cilat jan ato tash si ta shihni të udhes në rastë se e shihni të udhes procedone nuk e shini përshkak një parimi që para dy seancave keni vendos por e udhes është që pasi ka qenë një here me kalu por si ju mendoni vendimet e kuvendti nuk jan për mu thy.

z.Bekim Azizi, kryesuesi: Ne edhe në seancen e kalume bisedum që pa drejtor pika mos me u shqyrtu. Vendimi është i seances janarit konfirmimi i ligjshmires na ka ardh ka thanë që ky kembim duhet të merrë vlerismin nga ministra se ne kmei bë një hapë apra se me marrë vlersimin, vlersimin që e ka qu ministria ekspretet e kan bërë velrsimin e pronave, për vlersimin e pronave e keni marrë me e-mail materialin për 2 pronat që janë bë, parimisht ne si procedur e kemi kalu por të njejten procedur duhet me kalu dhe një here se vendimi jonë është marrë para se me bë vlerismin e ministris ndersa me ligje njehere duhet me u kerku vlersimi i minsitris tani me ardh në kuvend në bazë të vlerismit të minsitris me u bë kembimi i pronave, hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës, pasi që nuk ka për debat e qesë në votim pra me shumicën e votave pro asnjë kunder një apstenim, miratohet dhe kjo pikë.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetori të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2025.

z.Bekim Azizi, kryesuesi: Ju e dini që qdo vitë bëhet grupi punues për me hartu planin e punes së kuvendit komunal, bëhet plani drafti parë vjenë në kuvend delë në diskuim publik dhe në fund miratohet plani i punes së

kuvendit komunal, materialin e keni marrë me kohë dhe kemi parapa atë që prej 7 antareve të jetë perfaqësues të grupeve me mi propozu tash ka një, është dhe Reshati këtu, Fatlumi sekretari i kuvendit dhe një prej shoqeris civile dmth 7 antar dhe kryesuesi dmth është që merrë pjesë, nëse ka dikush me diskutu ose me i bë propozimet por gjithqysh të mundohemi të jetë edhe pjesa e gjinis femrore së paku bile prej kuvendit em u propozu 2 që me shti nga shoqeria civile 1 se prej 7 duhet em qenë së paku 3 se ndryshe na e kthejn jo të ligjshem vendimin.

z.Illir Zuka: Realisht sahere që kemi pas këtë pikë, d.m.th kanë shku shefat e grupeve gjithmonë, po tash për shkak që po kërkohet me pas edhe barazi gjinore do të diskutojmë ne dhe do ta japim emrin me kohë.

z.Musli Neziri: Emri i grupit të PDK-së, ne propozojmë Anisë Zejnullahun.

z.Illir Zuka: Emri i Grupit të LDK-së, Valentina Mehmeti.

z.Jakup Demiri: Emri i grupit të VV-së, Majlinda Shabani.

z.Bekim Azizi, kryesuesi: Faleminderit shumë! Pra, e qesim në votim. Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kunder, asnjë abstenim miratohet dhe ky vendim.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Kryesues, ke qenë edhe këto vite. Është mirë që në takimin e parë me ju drejtu drejtorave të drejtorive që çka kanë pika të rendit të ditës, që planin me harmonizu në plotni. Ti me siguri je edhe kryetar i komisionit dhe menjëhere ja dërgon edhe zyrave që mos të ju vonojnë në këtë drejtim dhe të jetë i harmonishëm me ekzekutivin.

z.Bekim Azizi, kryesuesi: Zakonisht deri në fillim të muajit pas seancës përher Fatlumi i thirrë drejtorët dhe ja u treogn pikat që i kanë, por zakonisht konsultohemi, këtë kemi si parim.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës:

7. Propozim vendim për plotësimin e Vendimit me Nr.01-110/05-834, të datës 31.05.2024 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës tek shtëpia e kultures “Gursel e Bajram Sylejmani” në shfrytëzim afatshkurt prej 13 viteve

z.Bekim Azizi, kryesuesi: D.m.th edhe më heret ja u dhamë nga një material shefave të grupeve, që vendimi që kemi bë heren e kalume na ka ardhë një harmonizim, sepse njëri vendim për me dhanë në shfrytëzim na ka kalu 15 vite e nuk e kemi diskutu hiq. Kur kemi dalë në vendimin e dytë, ne me rekomandimin e Remzisë kemi diskutu për afatin i gjatë 15 vite kur e kemi kalu me dhanë në shfrytëzim. Ne nuk kemi diskutu dhe ne në fund kemi marrë vendim për 13 vite, për shkak me i harmonizim me tjerat. Tash ministria na e ka kthi të ligjshëm vendimin, por ka thanë që duhet të harmonizohet kjo pjesa prej 13 vite në 15 vite. Hapi debat. Pasi që nuk ka për debat, a jeni që të miratohet ky vendim. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet dhe kjo pikë. Faleminderi për kontributin. Shihemi në seancat e radhes!

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:30 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi
